

EQREM ÇABEJ

## STUDIME RRETH ETIMOLOGJISË SË GJUHËS SHQIPE XII.

## K

**kërcû kërcû** m. «cung, kërcëp, rrënjë e drurit nxjerrë nga dheu». G. Meyeri 189 *kërcû* e bashkon përbrenda shqipes me *kërc* (te Rossi) «kërcu, kërcëp», *kërci* (i këmbës) e *kërcyell kërcëll* (i bimës), dhe të gjitha i bie të ardhura nga një sllav. *krę* — që ruhet në çek. *krę* «kërcëp, cung» serbokr. *kręiti* «me rrahue», prej nga ai nxjerr dhe gr. e re **κΟΥΤΣΟΣ** «i çalë» bashkë me **κΟΥΤΣΟΥΡΟΝ** «cung». Në Ngri. Studien II 97vv., Alb. Studien IV 72v. e V 89 spjegimin e tij për fjalën greke e tërheq, duke e çuar **κΟΥΤΣΟΣ** te **κΟΨΟΣ** «i prerë». Etimologjinë sllave e pranon për *kërcu* dhe Selisçevi 158.

Fjalë e gjuhës mbarë, që del sëpari te Budi (SC 321): e të *z̄i posiku* thëngjilli i shqimbunë, *kërcun̄i djegunë ndër rrahat*. Përdoret dhe metaforikisht, si substantiv i adjektivuar, me kuptimin «(njeri) i mjerë», fem. *kërcunë kërcurë* «e mjerë, grua e ve», *kërcura unë* «mjera unë», pas Lambertzit (f. 89) «nëna birvdekur, motra vëllavdekur; krahasim me kërcurin e thatë, sidomos në vajet popullorë». Nga ky përdorim i fjalës ka rrjedhur dhe *kërcunār* «i mjerë, i shkretë», që ka Junggu me Bashkimin. Një deminutiv me *-uq* kështë *kërcuq* «kërcu i vogël», fjalë që edhe kjo përdoret figurshëm për një njeri të mjerë, të shkretë, fem. *kërcuqe*. — Para G. Meyerit Kamarda (II 162v.) afroi *kërcu-në* me *kërci*, si dhe me *kërcë-n*, po krahasimi i mëtejme (me gr. *αζία* «zemër») as nuk diskutohet. Nga format e G. Meyerit, *kërc-i* i Rossit është i dyshimtë, *kërci kërsi* e *kërcyell kërcëll* mund të kenë lidhje me *kërcu*; e para paraqitet si zgjerimi i një baze *kërc-* me *-i -in*, e dyta me *-ell* diftonguar në *-yell*, sh. për këto Xhuvani-Çabej Prapashtesat 48v., 34. Etimologjia sllave mbetet fort e dyshimtë: forma e fjalës shqipe dhe farefisnia që duket të ketë me *kërci kërsi* e *kërcëll kërcyell* dëshmojnë më fort për një gurrë autoktone. Morfologjikisht nga forma e shquar e nga plurali i emrit (*kërcuni kërcuri*, *kërcuna kërcura*, *kërcunj*) shihet se ky është një temë nazale (ose një zgjerim sufiksial) *kërcun*. Prej kësaj forme të shqipes së vjetër, me vokal oral + *n* para se të zhvillohej në vokal nazal, rrjedh rum. *craciun* «kërshendelle», e cila ruan atë formë, sh. Studij si Cerc. lingvistice XII 3 (1961) 313vv. Kjo festë te Shqiptarët, te Rumunët, te Sllavët jugorë si dhe gjetkë e ka marrë emrin nga buzmi o kërcuri që ndizet atë natë feste në vatër; shq. *nata e buzmit* (sh. *buzm*), rum. *craciun*; për serbokroatishten plot shembëlla të E. Schneeweis, Die Weihnachtsbräuche der Serbokroaten passim. Khs. përgjithësisht edhe Meringer IF 16, 154vv. Me këtë bien gjithë spjegimet e gjertanishme të fjalës rumune, goftë prej latinishtes (*crastinum*, *creationem*, *calationem*, *Christi ieiunium*), goftë nga sllavishtja, përmbledhur sëfundi te Rosetti (Mélanges 324vv) e te Vasmeri REW I 633. Përkundrazi, *kraçun* «kërshëndelle» e gjuhëve sllave buron prej shqipes nëpërmjet të rumanishtes.

**kërçep** m. «kërcu, degë tërthore, krande e thatë, ashkël», figurshëm «njeri kokëtrashë»; te Tasi 25 edhe «sakat, ulok». Mungon te G. Meyeri. Lidhet etimologjikisht me *kërçabë* f. «një farë kulari në formë trekandshi me thepa, që u vihet derrave në qafë për të ndaluar që të hyjnë përmes gardhit në ndonjë kopsht a arë»; *kërçep* me e-në e saj prej a-je është formë plurali e singularizuar, sh. Li. Posn. VIII 91. Duke qenë *kërçabë* fjalë e geg. veriore (gjindet te Junggu e Bashkimi), në -b-në e saj paraqet sonorizimin e okluzivit të silabës fundore, **karakteristik** për atë dialekt. Kështu forma bazë e fjalës është *kër-çap kër-çapë*; *kër-*prefiksi i ditur e -çap -çapë = çap-i «hapi» e çapë «kafshatë» çapëloj etj., që i përkasin rrënjës indoeur. *skep-* «çaj, gdhend, pres». Prefiksi *kër-* ndeshet bash nëpër emra shkopinjsht, si në *kërçingël* (te Gazulli), në *kërbathër*, sh. Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4, 1956, f. 73.

**kërëndi** f. «copëra murësh, gëlqere, pluhur etj. që bien kur rrëzohet a kur shëmbet një mur galtinë». Fjalë e tosk. jugore, që s'gjindet nëpër fjalorë. Nga turq. *kirinti* «thërmiqe bukësh, gastare të thyera», prej *kirmak* «me thye». Asimilimi nt:nd vepron dhe në huazimet turke, sh. *kandar*.

**kërmë** f. «ngordhësirë, coftinë; trupi gangull i bagëtisë së therur». As bashkë me *kërdis kërdi* f. nga turq. *kirdirmak kirmak* (G. Meyer 188), as nga gr. e re **κορμί κουρμί** «trup» (Kristoforidhi 154), se kjo ka dhënë në shqipen *kurm*. Si fjalë e toskërishtes, *kërmë* rrjedh prej bullg. *къма* «hejë bagëtie», sh. Bul. për Shk. Shoq. 2 (1954) 42. Nga «ushqim» u zhvillua kuptimi «mish», andej «ngordhësirë». Khs. lat. *caro* «mish», lat. vulgare *\*caronia* «ngordhësirë»; khs. dhe *carazzu* «kërmë» në dialektin kalabrez të italishtes (te Rohlfs. Diz. dial. delle tre Calabrie I 161). — Me *kërmë* mund të lidhet *kërminë* f. «plëndës» te Fjal. i gj. shqipe, si një zgjerim me -inë. Nuk duket të jetë popullore fjala *kërmtar* m. «ai që rjep bagëtinë e therur» te Manni. Po mund të jetë popullor mbiemri *kërmak* «si kërmë» i G. Meyerit.

**kërmill** m. G. Meyeri 182 jep format *kaçamill këthmill kërmill krëmill kërmil këmill garmill*. Ai bashkohet me një mendim të Schuchardtit i cili gjen këtu një fjalë romane, të afërt me port. *caramujo* «kërmill deti», frgj. *escargot* «kërmill», po në shtesat e Fjalorit (f. 525) dyshon për këtë barazim, për punë të fjalës **ἀκραιμία** «kërmill» që jep Heziku për dialektin e Tarentit. Me mendimin e Vasmerit (Studien I 27), i cili e spiegon këtë fjalë nga gr.-lat. *ceramida* «kërmill», bashkohet Bariçi (Arh. za arb. star. I 214), po ky më vonë (Hymje 57) sheh aty një relik të para-indoeuropian. Afrimin e *kërmill*-it me *karmë* «karpë, shkëmb» nga ana e Ostirit e kundërshton me të drejtë Jokli (IJ XI VII 184). I drejtë mbetet vetëm mendimi i Cimochowskit (Li. Posn. III 165 vv.) dhe yni (poaty VIII 107): *kërmill* lidhet me *krimb*; është një plural i singularizuar, singularizimi i formës *kërminj kërmij* që është plurali i *krimb*-it. Plurali *kërminj* përveç *kërmill*-it ka dhënë si singulare dhe fem. *kër(r)mi-a* «Anobium pertinax, një lloj krimbi i drurit», e mashk. *kërmil* te Kavalioti (G. Meyer, Alb. Studien IV 103) e te Mitko.

Fjalë e gjithmbarshme e gjuhës, me mbizotërim të formës *kërmill*. Bogdani (I 143, 2) e ka *këmill*: *tue lanë shenj, posi këmilli kahëdo v ëj* «lasciando il segno, come la lumaca, ovunque andava». Kësaj i përgjigjet *kmili* prej Acquaformose të Kalabrisë (Rohls AIS III 461), si një nga pjekjet e veçanta të arbërishtes së Italisë me geg. veriore. Singularizimi në trajtën *kërmill*, e cila mund të quhet e përgjithshme, meqë çfa-

qet dhe nëpër dialektet e kolonive, duhet të jetë mjaft i mocëm, një nga singularizimet e para të shqipes, ashtu si *gjeth gjethe, rrëshék, thelb, thes, rreth, shtrep, lagje*, për të cilat sh. Li. Posn. VIII 121. Përndryshe fjala ka pësuar mjaft shformime. Kështu Kristoforidhi te Psalmet gegërisht (58, 8) ruan trajtën e vendlindjes së tij: *Shkofshinë posi këthmīll qi tretetë*, trajtë që jep dhe Weigandi 37. Në shumë vise fjala është marrë në ndjenjën gjuhësore si *kër-mill*, dhe prej këtij zbërthimi popullor kanë dalë trajta të reja. Nga këto më e njohura është *kaçamill* (dhe në Gjakovë, Kujundziç 53), ku *-mill* u përngjit me *kaça-*. (Disi ndryshe Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4, 1956, f. 74: *kaçamill = kaça-e kërmill*. Ndryshe dhe Cimochowski, që mendon për kontaminacion të fjalëve *kërmill* e *\*kaçall(ë)* prej *kaçallok* «kërmill; guaskë, gocë deti; koci i kafshës së bagëtisë»).

Prej *kaçamill* me rënie të silabës nistore u formua *çamill* (sh. këtë fjalë). Në Piana dei Greci të Siqelisë ka hyrë prefiksi *kaka-*, duke dhënë *kakam* χ *kakami* γ m. Trajta *garmill* (te G. Meyeri) paraqet sonorizimin e shpeshtë të *k-së* nistore e ndrimin *ë:a* në pozicion paratheksor. Te tjetra trajtë *kërméc* (e Tasit), *-ill-i* fundor i fjalës u ka zëvendësuar me sufiksën *-eç*. Shohim kështu sesi një fjalë e vetme me anë regresionesh e zbërthimesh të ndryshme të etimologjisë popullore ka zhvilluar rreth vetes një tufë ndrimesh proteike. Me këtë spjegim me mjete të brendshme të gjuhës bie tani dhe krahasimi jashta shqipes që ndërmer K. Bouda në IF 59, 208.

*kërnëtë gërnëtë* f. «klarinetë». S'e ka G. Meyeri. Weigandi 36 e shënon si fjalë italiane, po pa caktuar burimin. Ndërsa *klarinetë* është një huazim fare i ri nga it. *clarinetto*, *kërnëtë gërnëtë* është një fjalë popullore nga it. *cornetta*. Ruajtja e grupit *-rn-* dëshmon për një huazim mjaft të ri. Huazim popullor më i vjetër është *gareta* e Buzukut, nga *gërnëtë \*gërretë*, me asimilimin *rn:rr:r*: *E sã ku bane kryq, kur të bjerë gareta e ; prapmeja* «In momento, in ictu oculi, in novissima tuba» (LXXXIX = CIX, Korintasit I 15, 52). Te kjo fjalë e te *gërneta* e sotme shihet sonorizimi i shpeshtë i silabës *kër-* në *gër-* në ballë të fjalës, sh. *gërbulë, gërshet*.

*kërqelë* f. «thikë brezi». Mungon te G. Meyeri. E jep Kristoforidhi për Tiranë me trajtën *kërqellë* «thikë që mbanë ndë brest», si një fjalë të vjetëruar. Me *-l-* velare (*-ll-*) e shënon dhe Weigandi 36: *kërqëll-a* thikë me hallkë, që mbahet në brez», duke e nxjerrë, bashkë me rum. *cercel* «vath i veshit», prej lat. *circellus* «rreth i vogël, hallkë». Kështu edhe Skoku (Zbornik Resetar 429 vv.), duke e afruar fjalën e shqipes veçanërisht me *cercelli* «vathë» të dalmatishtes mesjetare të Raguzës e me gr. e re γρικέλλιον «hallkë e derës». Mendim i pranuar dhe te Jokli (Indogerm. Anseiger 35, 35). Për format e greq. së re e të mesme sh. edhe G. Meyer, Ngri. Studien III 30, për të dalmatishtes Bartoli Das Dalmatiche II 268. Khs. dhe Meyer-Lübke REW 1939, e për dialektin kalabrez të italishtes Alessio, Annali d. Fac. di Lettere e Filos. Bari I 23.

Në gjuhën shqipe fjala është emri i një thike, kurse lat. *circellus* rron kudo me kuptimin «vath». *kërqelë* nuk është gjë tjetër veçse një trajtë krahinore e fjalës *kurtjelë* «lloj shpate e shkurtër e drejtë», me ndrim të vokalit paratheksor në *ë* e të grupit *tj* në *q*, ndrimi i fundit i shpeshtë në geg. jugore e lindore (khs. *qerm, qetër* «tjetër» etj.). Sh. tani dhe vretjtet tona në Revue de Linguistique VII 1 177.

**kërshëndella, kërshëndelle** fpl. Ndërsa Miklosichi (Alb. Forschungen II 176) e G. Meyeri 189 e nxirnin nga lat. *Christi natalia*, Pedersen, (KZ 33, 539) me më të drejtë, për punë të l-së velare, e spiegon nga lat. *Christi natale*. Skoku (Arhiv za arb. starinu II 112, Revue d. ét. slaves VII 190, Razpr. Jzd. Znanstv. Dr. za human. vede v Ljubljani 4, 9) vë në pah rolin e kishës së Docleas në përhapjen e fjalës. Khs. dhe Tagliavini 159 e 316. Për përpjekjet e K. Gurakuqit (Ora 1 Nr. 5 f. 19), të A. Fishtës (HD VIII 13 vv.) e të D. P. Sulit (Leka V 52v.) që ta spiegojnë këtë fjalë me mjete të shqipes, nga një kompozit *Krisht këndellë* «këndellja e Krishtit» (B. Palaj HD X 284 shën. 4 nga *Sh. Knella*), le të shihet kritika e drejtë e Joklit (IJ XV VII 136, XVIII VII 175, XIX VII, 226). Ndërkaq te *krishndellet* e Weigandit (8,39) ndikimi i emrit *Krisht* me etimologji popullore nuk mohohet.

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku (XIVA) *djerie mbas. Krëshëndéllsh;* Budi (RR 204, II 1, SC 34, 122) njëjës *natëçë kërshëndéllesë, jashtë ditëçë kërshëndéllesë; pashkënë e kërshëndéllënë*, po *M pashkëshi cë mëdhë, Rshajesh, e kërshëndellesh;* për toskërishten sh. Hahn I 154 e Fjalorin e tij f. 45. Si shumë emra të kremtesh, ashtu edhe ky më fort përdoret si plural, sh. Li. Posn. VII 161; prandaj *-e* e *-a* te *kërshëndelle* *kërshndella* janë mbaresa plurali. Këndej spiegot dhe metafoia, duke pasur dhënë *Christi natale* në shqipen *\*kërshëndáll*, që në plural dha pastaj *kërshëndelle*, Li. Posn VIII 118v. Historikisht kjo fjalë është i vetmi refleks i lat. *Christi natale*, e cila nuk rron gjëkund në fushë të gjuhëve romane, khs. tani Revue de linguistique VII 1 168. Fjalës latine morfologjikisht i përgjigjet gr. e re *χριστούγεννα*, që është edhe kjo «të lemit e Krishtit», edhe kjo një plural ashtu si shq. *kërshëndella* *kërshëndelle*. Kjo e fundit me fjalën greke piqet dhe në kuptim: Në Jugë pas Hahnit *kërshëndellet* janë gjashtë javët e kreshmëve që para *kërshëndelleve* e gjer në Teofani; poashtu afërsisht dhe *χριστούγεννα* në greg. të re, sh. Dimitrakos IX 7910. — *krish(t)lindje* është neologjizëm, pas gjase një përkthim, një kalk i ri i fjalës greke.

**kërshnjét** m. «Phillyrea media, një lloj krifshë». E jep Mitrushë 387 për Krujë. Lidhet me *krifshë*, emër po i këtij druri, me sufiksin lokal *-et* përdorur për të shënuar drurin e veçantë, «pyll krifshash» për «krifshë», sh. Li. Posn. VIII 98. Zgjerimi i sufiksit *-et* në trajtën *-njët* u detyrohet disa emrave si *kashnjët*. Si zhvillim të fjalës do të mendojmë pra *\*krifshnjët; \*kërshnjët*. Në grupin e tri konsonanteve *fshnj* ra spiranti labial, si më i dobëti në kumbim.

**kërthnezem, kërthndezem** «kuqem në fytyrë; rihem, përtërihem; marr jetë, marr zemër, trimërohem; harlisem (për qenie, për bimë); tërhuzem»; i *kërthneztë* «i gjallë, i ardhangët». Fjalë e geg. veriore, që mungon te G. Meyeri; e ka Cordignano e Gazulli, Bashkimi *kërtnezem* «infuriare, divampare dal furore». Bashkë me *kërnezem* «ngrohëm, nxeëm» të Lumës (te Manni) është një formim me *kër-i* fjalës *ndezem*; khs. dhe Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4, 1956, f. 73. Lidhjen me *ndezem* e vuri re sëpari Shp. Bardhi (Leka VII 424) si edhe Gazulli (f. 201), kur e afron fjalën me *m'u mbërdhezë* «m'u kuqë»: *u mbërdhez fytyret*, e me *i mbërdhezët* «i kuq si gjaku». Për kuptimet metaforike «rihem» «trimërohem» nga «skuqem» khs. *këndellem*. Ndërsa *kërsnezem* *kërthnezem* është *kër-ndezem* (me asimilimin dialektor *nd : n* e me një *-s-* o *-th-* inorganike në grupin fonetik *-rnd-*), *mbërdhe-*

zem është formuar nga dhezem me mbër-. Trajta dhez për ndez ekziston dhe në geg. veriore, khs. dhe vezulloy.

**kërveshem** «shtrembëroj buzët, në shenjë shpotie, talljeje», Mungon te G. Meyeri. Eshtë një verbum denominativum i vesh-it, me kuptimin «zgërdhihem, hap buzët vesh më vesh»; një kompozit me kër- për të cilin sh. Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4(1956) 73. Një variante me sonorizim të guturalit nistor është *gërveshem* te Bashkimi. Një tjetër variante, me ngër- për kër- e me ndrimin (e shpeshtë) të spiranteve *v* e *dh* (*vjoli: dhjoli*, khs. dhe *dhjamë: vjam*), është *ngërdheshem* «përdredh buzët a shtrembëroj fytyrën për të përqeshur tjetrin, kërveshem», te Bashkimi «far sberleffe», te Godini «hohnlachen», te Lamberti 135 «grinse, schneide Gesichter». Khs. për formën *kërleshem* e *ngërleshem*, *kërcëllij* e *ngërcëllij* në vendin e cituar. Midis *gërveshem* e *ngërdheshem* qëndron trajta *gërdheshem*.- Sh. dhe *ngërdhucem*.

**kësen** (*më*) «më ther», *më kësen barku* «më dhemb barku», e *kësýmeja* (e *kësýmja*) «dhimbjet e barkut». G. Meyeri 190 e nxjerr nga turq. *kismak* «me shterngue, me ndrydhë». Bariçi (I 39v.) e merr për fjalë thjesht shqipe (nga një bazë indoeur. \**kuo* (*ontio*) dhe e krahason me lit. *kencù* «duroj, pësoj», irl. e vj. *céssaím* «vuaj, heq» gr. *πένθος πάθος* «helm, vuajtje», *πάσχω* «vuaj».

Fjalë dialektore, që e jep Hahni 46 (*më kesen barku*) e Kristoforidhi e dëshmon për Elbasan. Logoreci 58 e ka *ksen*, me një shembëll për dhimbjet e shpatullës. Nuk është gjë tjetër veçse *këcén*, në Gjirokastër *më këcén zëmra* «më hidhet zemra»; prej këndeje u shtri përdorimi dhe për dhimbjet e barkut. Për zhvillimin e kuptimit khs. p.sh. *më nget kryet* «më dhemb kryet».

**kështjell** m., *kështjellë* f. Merret përgjithësisht, bashkë me formën *kastjël* të de Radës, për një huazim nga it. *castello*; khs. G. Meyer 191, Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1043, Helbig 30, 76.

Ndryshimet fonetike që ka pësuar kjo fjalë: reduktimi i *a*-së së pakte në *ë*, diftongimi i *e*-së, ndrimi i *s*-së në *sh*, dëshmojnë më fort për një huazim nga lat. *castellum*; për të tilla kritere dallimi të latinizmeve të shqipes nga italianizmat sh. vrejten tona në Revue de Linguistique VII 1 175v. Atëhere si formë primare do marrë *kshtjël kështjël* (Jungg, Bashkimi), te G. Gurakuqi (HD III 521) *këshqël* (me *tj: q*) në pajtim me rregullën e Pedersenit (KZ 33, 536) që refleksi i lat. *ll* (geminate) në shqipen është *l*. Prandaj ne me *l* palatale e lexojmë këtë fjalë dhe tek autorët e vjetër të Veriut, me gjithë se grafia e tyre lë vend për dy lexime. me *l* e me *ll*: Buzuku (LXXI = LXXXI, Luka 9, 6) *E ata por uinjinë përquark kështjelavet* «Egressi autem circumibant per castella». Bardhi s.v. Castellum, Oppidum. Edhe arsyet e kuptimit flasin për një huazim të kohës latine; kështu *Emënatë e Gjytetevet e të kështjelet Arbënit* «Hoc est proprium nomina Urbium nonnullarum, atque Castellorum, ad eam partem Macedoniae spectantium quae Epirus, sive Albania dicitur.» te Bardhi 196 shënon qytetet mesjetare zhvilluar rreth një fortëse. Kështu kjo fjalë, si një huazim pas gjase prej latinitetit të vonë, shkon bashkë me gjerm. e lartë të vj. *kastel*, irl. e mesme *castel caisel*, korn. *castel* etj. që burojnë prej lat. *castellum*; khs. për këto Pedersen Kelt. Gram. I 219, Walde-Hofmann I 180, Kluge-Goetze<sup>11</sup> 289. Për reflekset sllave të fjalës latine sh. Berneker I 582, Vasmer REW I

**641**, për gr. **καστέλλος** Triandaphyllidis 92,130. Në shqipen forma **me ù-** (l velare) dokumentohet vonë pas gjase është sajuar prej shkrimtarëve. Në qoftë se është me burim popullor, do t'i detyrohet ndikimit të it. *castello*. Thjesht italiane (kalabreze) është *kastjël* e arbërishtes së Kalabrisë.- Gjinia femërore e *kështjellë-s* për ne nuk ka lidhje me nominativ-akuzativin (Jokl IF 36, 98vv.), po rrjedh prej pluralit më *-a*, karakteristik më fort i femërores, i cili dha shkas për lindjen e një femëroreje më *-ë*, pas skemës së shpeshtë *fusha* pl : *fushë* sing.; khs. edhe *këshill*.

**këshyre**, *kshyrë* f. «shteg në grykë të malit, rrugë e vështirë në mes të malit». Fjalë e anëve të Tomorit, dëshmuar në të dytën trajtë prej Ed. së Re (te Manni), në të parën nga Fj. i gju. shqipe. Për punë të *y-së* për *u* e të *sh-së* rrjedh më fort drejtpërdrejt nga lat. *clausūra clūsūra* sesa nëpërmes të gr. së mesme o të re **κλεισοῦρα** «grykë mali», ose të serbokr. *klisura* a bullg. *klisura* «grykë mali, qafë mali». Kështu *këshyre* *kshyrë* e *klisyrë* *klisyrë* paraqesin dy shtresa huazimi prej kohësh së ndryshme e prej vatrash së ndryshme; sh. *Revue de Linguistique* VII 1 183. Prej *kl-së* latine do t'u priste *q-*; *k-* te *këshyre* *kshyrë* spiegotet si te *kishë* për *qishë*.

**këtú**. Fjalë e gjuhës mbarë, gjer më sot e paspieguar. Boppi (f. 496 v.) që i pari që pa se përbëhet nga *kë-* e nga *-tu* dhe se *kë-* është i njëjti element si te *këtë*; po arsyetimi i mëtejme i tij se *këtu* rrjedh prej një teme përemërore, akuzativi i së cilës qenka *këtë*, dhe se *kë-* i përgjigjet temës pyetëse si në ind. e vj. *kā* «kush» sllav. *kto* «kush», nuk është bindës gjëkund. Nuk ka dyshim se *kë-* është elementi i ditur me funksion deiktik për afër, si te *ky* *kjo*, *kështu* etj. Mendimin e Pedersenit (Les pronoms démonstratifs de l'ancien arménien 315) që *ky* element te *këtu* përmban një imperativ të vjetër indoeur. \**koue* «shih», me të drejtë e vë në dyshim Walde-Pokorny I 369. *këtu* përbën një çift opozicioni me *aty*, po është për të vënë re se për këtë nuk mungon dhe trajta *atu* me poatë rrënjor si te *këtu*: në disa vise të Kosovës (Elezović, Arhiv za arb. starinu II 249 Jokl IJ XIII VII 117), sporadikisht në Krujë, si edhe (Tagliavini 73v.) në Arbënesh të Dalmacisë. Mundet që *atu*, e cila bën një çift me *këtu* edhe në punë të rimës, të ketë pasur një përhapje më të madhe; ndër të tjera mund të jetë edhe formë e Buzukut, grafia *atu* e të cilit lexohet *aty*, po edhe *atu* si e ka dhe Arbëneshi i Dalmacisë. Primitivi *tu* i *këtu-së* është i gjallë edhe sot, në adverbën *njitu* «bash këtu, ecce hic», ku *nji* «ja, qe» zëvendëson në një farë mënyre prefiksin *kë-* në funksionin e tij hiperkarakterizonjës, sh. Studii si Cerc. *linguistique* X 4 (1959) 535. Elementi *tu* gjindet dhe te *tuk* «ku» (*tu-k* «aty ku»), te *tëhu* e te *duke tuke tue* (Pedersen 201, 120), si edhe te *tutje* (*tu-tje* *kë-tu* + *a-tje*) e te *ashtu kështu* (*a-sh-tu*, *kë-sh-tu*), sh. këto fjalë. Këtë *tu* që çfaqet kështu nëpër kompozite, Pedersen (f. 141) e gjen të paqartë. Për ne është baras me sllav. *tut tu* në rus. *tut* «këtu» serbokr. *tu* «aty, këtu» etj., si një konkordancë e veçantë e shqipes me sllavishten. Më tej i përket përemrit indoeur. *to-*, duke u afruar kështu përbrenda shqipes me *të*, sh. këtë fjalë. Me këtë analizë kuptimi lokal i pari i *tu-së* te *këtu*, *tu-k*, *tu-ke*, *du-ke*, *tu-tje* etj. del se ka qenë indiferent në punë të afërsisë e largësisë, ai ishte përgjithësisht «në vendin e caktuar». Vetëm në bashkim me *kë-* dha domethënien «këtu», poashtu si i *tillë* që dha i *këtille* përballë trajtës *i atillë*. — Për kuptimin kohor në shprehje si

*këtu e tutje, këtu e tre vjet*, në krahasim edhe me greq. e re (ἀπ' ἐδὼ καὶ μία ὥρα «para një ore» = «që këtu e një orë») khs. Fraenkel 1f' 43, 309.

*kiç* m. «pjesa e mbrapme e anijes; pjesa e parme e saj». Fjalë e geg. veriore, që mungon te G. Meyeri. Nga turq. *kiç* «pjesa e mbrapme e çdo sendi; pjesa e mbrapme e anijes».

*kij* «tëharr hardhitë»; *kizë kizë* f. «vegël si drapër, me të cilën kijnë hardhitë». G. Meyeri (f. 226) i cili mbi dëshminë e padrejtë të burimeve të tij e shkruan këtë fjalë, si verb e si emër, me palatal, pyet mos vjen nga lat. *incidere* «me gdhendë», etimologji që me të drejtë e dyshon Tagliavini 147. Bariçi (I 40) e afron përbrenda shqipes me *shkryej shkryej*, po një bazë me *kl-* që supozon ai n'atë mes, nuk haset gjëkund.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që te Buzuku (LXXXVII = LXXXXVII, Kënga e Këngëvet 10, 12): *e hera me kiem u afëruo* «tempus putationis advenit». Kjo formë ruhet gjer më sot në geg. veriore, te Rossi *kies kiestár* m. «ai që kin hardhitë», në Mirditë (D. P. Suli HD XIII 396) *Me kizë vëshët si m Spaçai kurkund s'prekin kizë*. Me gjithë se dëshmohet kaq heret, *kiej*, si një formë verbale që s'ka analogji, duhet të jetë sekundare, përfundim i diftongimit të *e-së* në ato dialekte, si te *kie* «ke», *çie* «qe» plurali i *ka-ut* etj. Forma e mirëfilltë është *kij*, siç shihet dhe nga *kiza* që është e përgjithshme. Kuptimi metaforik i *ja kij* «ja kaloj, ja dal» (në lodrën e arrave, po edhe përgjithësisht) është mjaft i përhapur në Gegëri (Elbasani, Puka e mbarë geg. veriore). Postverbali *kizë*, geg. *kizë*, del që te Bardhi: Scirpicula, falcetta *Kiza*, te Boçari 37, e te Leake 322 *kizë* «κλαδευτήρι, bill, pruning-hook», në Ğreqi (Reinhold, Glosari 23) *çë do myza nga kiza?* Kuptimisht më fort se një deminutiv i mirëfilltë është një emër përdorëse formuar me *-zë* deminutive, sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 108. Te ky emër format *kizë kizë* shpien te një bazë \**kinëzë*, si *gjizë gjizë* te \**gjinëzë*, *kërthizë kërthizë* te \**kërthinëzë*, *rraxë rrëzë* te \**rranëzë* etj.; te këto — ndryshe nga *anëzë arëzë* — *-ë-ja* e pahekse e trupit të fjalës ra qëmoti, duke mos lënë vend kështu për rotacizmin. Prej *kizë-s* ka dalë *kizoj*, për kuptimin e së cilës sh. Tasin f. 23, e kompoziti *këmbëkizë kambëkizë* «që i ka këmbët kthyer përbrenda si kizë». Nga *kij* m'anë tjetër — sikundër e pa Kristoforidhi 157, 392 — është formuar adverbi geg. (*për*) së *kithi* «shkarthi, kërthazi, tërthori», e *preva për së kithi τό έκοψα πλαγίως*, sh. Bul. për Shk. Shoq. 2 (1954) 43. Në Veri për këtë përdoren trajta me *-ie-* si te *kiej* vetë, pas Gazullit në Pult *për kiëmaz*, në Spaç *për së kiemi*. Një tjetër formim që ka dalë nga *kij* është *përkyej* «shtrembëroj, lakoj» *përkyhem* «shtrembërohem, lakohem, *kenka përkye muri* «paska lëshuar bark», që dëshmon Kristoforidhi për Gjakovë (*përkyj*) e Gazulli për Hot e Malsi të Madhe *me përkye*, formë me labilizim të *i-së ie-së* në *y ye*.

Për etimologjinë e fjalës peshon forma e saj. Nga pikëpamja fonetike bie në sy *k-ja* velare përpara *i-së*, e cila tërhoqi vemendjen e Pedersenit (KZ 36, 327) në lidhje me përhapjen e fjalës në gegërishten, po që në këtë rasë është e mbarë gjuhës. Kjo gjë dëfton qartë që *k-ja* nuk gjindet lashtërisht para vokalit të çelët, sepse një i tillë vokal do ta kish palatalizuar. Morfologjikisht *kij* paraqitet si një verb i zgjeruar me *-inj*, *-ij*, ashtu si *kërpjij kuprinj* nga *kryp krip*, *mbëllij* nga *mbyl*, *zvërdhij* nga *zvërdh*, khs. dhe *dërsij*: *djersë*, *sëllij*: *sillë*; sh. për këtë klasë verbale Pedersen, Roman. Jahresbericht IX II 211. Fonetika e morfologjia e fjalës shpien kështu te një më e hershme \**këinj*, ku *ë-ja* mund të

jetë refleksi i një tjetri vokal të mëparmë. Kështu *kij* me *kizë kizë* gjan të lidhet me *kadhë* f. *kadhëm* m. «një farë drapër a kizë me bisht të gjatë, me të cilën shkadhisin ferrat e drizat». Cilido që të jetë burimi i spirantit të sotmë *dh* të *kadhë-s*, *kij* nga \**këinj* pasqyron idealisht një \**kadh-iniō*, ku me *dh* do kuptuar okluzivi i zëshëm ose grupi konsonantik që ka qenë paraforma fonetike e *dh-së* së sotme. Te \**kadh-iniō* ra qëmoti okluzivi i zëshëm ndërmjet vokaleve; *a*-ja paratheksore u shurdhua në *ë* (\**këinj*) e kjo mënëfund ra fare. Kjo rënie u bë relativisht vonë, gjatë zhvillimit të brendshëm të gjuhës, ashtu si te \**këy*: *ky*, përkundrajt fem. *këjo*, sot *kjo*, — Gjurma e kontraktionit të \**këinj* në *kij* është gjatësia e vokalit të *kij* e krahasueshme me atë të *hyj*; *li* nga \**kadh-iniō* si *hyj li* nga \**hodiniō* Mbase nga *i*-ja e gjatë doli dhe diftongimi te *kiej kiem* që u përmend më sipër. Trajta e zgjeruar e *kadhë-s*, *kadhëm*, ndikoi mbi *kizë-n*, duke dhënë shtysën për sajimin e *kizëm*, të cilën e ka Godini.

**kinse** «gjoja, sikur». Fjalë e geg. veriore, e paspieguar gjer sot. Del oë te Buzuku (XXIIa: XXXVIII, Romakët 12, 16); *kinëse aj lā* e *aj s kā tue mos u bām kinëse di kafshë të mëdhā* «non alta sapientes»: Bardhi Ut *Kinëse*. Ut eatis *Kinëse të veni*. Sot *kinse*, me rënie të *ë-së* së pathekse. Është një nga ato fjalët e shqipes që kanë dalë prej fjalish: *kinë* se është imperativ i *kini* se «zeieni se», me ndrim të *i-së* së pathekse në *ë*. Ky spjegim vërtetohet me këtë, që në vend të *kinëse* Buzuku një herë (LXXXVII, Luka 10, 32) vetëm *kini*: *bani nukë e sheh* «bëri sikur s'e pa». Ky autor me grafinë e ndarë *kinë se* duket ta ketë ndjerë fjalën ende si një sintagmë, jo si një fjalë të vetme. — Ky koncept edhe në të tjera dialekte shprehet me një mënyrë të afër me këtë: Gjirokastra zese «kinse» = *ze(je)se*; Ali Ulqinaku për «gjoja» ka *banse* = *ban se*. Te *kinse* ruhet ende kuptimi i fjalës *kam* për «zë, kap» (sh. *kam*). Një variante të *kinse* e ka Kurti (I<sup>2</sup> 36): *Fjalë-fjalë, çohet njëni kesh se po tham dishka...*, ku *kesh* është forma *keshë* e imperfektit. — Sh. edhe *korsëm*.

**kite** f. «dorëz kallinjsh të grurit», në Mallakastër; në Seman «kalli gruri pa bisht, kallëz», *mblehim kitet* «mblehim kallëzat», te J. Thomaj Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4, 1961, 147; në Vlorë «dorëza kalli gruri të njoma që përcëllohen në zjarr dhe hahen poashtu si misrat» (A. Asllani, Drita II Nr. 15 = 68 f. 2). Mungon te G. Meyer i e në fjalorët e tjerë. Huazim krahinor nga sllavishtja: bullg. *kitka* «tufë, tufë lulesh», serbokr. *kita* «tufë, xhufkë» *kitast* «tufshak». Për arsye dialekt-geografike si burim vjen në vështrim bullgarishtja. Fjala sllave ka hyrë, si *chita*, dhe në rumanishen. — Me *kite* është identike *kitë* f. «jele e kalit» (po edhe *kitë* «hell akulli» te Cordignano?). Renditja e *kite-s* në klasën e femërorëve më -e ka burimin në tendencën e shqipes për të bërë femërore disa kategori të caktuara të emrave, khs. për *kite* Li. Posn. VII 170vv. — Sh. edhe *ketër kitër*.

**klap** f. «jerm», *flet kllap* «flet jerm, flet përcart». Fjalë e geg. veriore, që s'e ka G. Meyer i. Jungu e Bashkimi *kllap* m. e *kllap* f. «vaneggiamento», *me ra në kllap* «vaneggiare». Gazulli 206 jep për Malsi të Madhe *kllap* «gjumë i lehtë», *kllap* «jermi, fantazi», *me kllapuritë* «me folë kllapina, me jermue». Jo nga serbokr. *klopiniti*, si mendon ky autor, po nga serbokr. *klapa* «jerm». Kjo dha në shqipen *kllap*, *kllapi-a*

është një zgjerim i brendshëm i shqipes, si te *popull e populli*. Huazim me përhapje krahinore.

**kodër** f. «vend i ngritur, më i lartë se bregu». G. Meyeri 193 nuk jep ndonjë spjegim, po vuri re vërtet afërinë e fjalës me rum. *codru* «pyll, mal» arom. «treg, mal me pyje, bjeshkë; copë bukë e madhe» megl. «treg; copë ëmbëlsire katrore» istrorum. «mal me pyje, bjeshkë». Lidhja e të dy fjalëve midis tyre ndërkaq nuk është sqaruar. Shumica e gjuhëtarëve anojnë nga mendimi që rum. *codru* rrjedh nga lat. *quadrum* e *kodra* e shqipes prej rumanishtes; khs. Pedersen KZ 40, 212v., Densusianu (Hist. d.l.I. roum. I 71v. Graisi Suflet II 321), Candrea-Densusianu 384, Capidan Dacoromania I 509, Tagliavini Riv. d'Albania II 185; sh. dhe Weigand 37, tani rishmë Marlekaç Quaderni V 46. Kjo tezë u përforcua që kur Skoku (Archiv f. slav. Phil. 37,83 e 84) — më parë Schuchardti. Vokalismus des Vulgärlateins II 510) — konstatoi zhvillimin e fonemit *qua* në *co-* nëpër mbishkrime latine vulgare, *Codrato* për *Quadratus*. Një të tillë shqiptim Brüchu (Z. f. rom. Phil. 56, 376 vv.) nëpërmjet të emrave *Quodratus Codratus* e të glosave si *codra* për «quadra» e mendon për lat. vulgare lindore të kohës perandorake; prandaj ai shq. *kodër* e rum. *codru* i nxjerr nga lat. vulgare *codra codrum*. Mendim i pranuar dhe te Sandfeldi 48 shën. 1. Aty hyn dhe toponimi *Codroipo* i Friulit, pas Rohlf'sit. (Archiv f.d. Studium d.n. Sprachen 184, 107) nga lat. *Quadrivium*. Khs. edhe Jokl IJ VIII VII 83. Ernout-Meillet 836, Jordan Arhiva XXXVIII 39, 47, Ostir Arhiv za arb. starinu I 123. Për përpjekjet e Diculescut (Dacoromania IV 436v.) që të spjegonte ndrimin *a; o* me anën e shqiptimit grek të fjalës latine e të kërkonte burimin e këtij shqiptimi gjer në dialektin eolik të greq. së vjetër, sh. Jokl IJ XII VII 85. Ndërkaq për një periudë më të vonë ndërmjetësimi i greqishtes për një shqiptim të lat. *quadrum* si *codru* në rumanishten nuk është për të hedhur dhe fare poshtë, atë e pranon në parim dhe Meyer-Lübke REW 6921/2. Për *kodër-n* e shqipes ky dietar lëkundet midis rum. *codru* si burim dhe një rrënje autoktone. Në këtë drejtim Scheffelowitz (Bezenbergers Beiträge XXVIII 157, Z.f. Indol. u. Iranistik 6, 120) *kodër-n* e kish krahasuar me arm. *katar* «kulm, majë, kokë», duke parë te rum. *codru* një fjalë të burimit shqiptar; mendimin e tij e pëlqen dhe Puscariu EW 392. Për fjalë vendi e merr *kodër-n* edhe Bariçi (I 40), duke e krahasuar etimologjikisht me lat. *castrum*. Sh. dhe Tagliavinin IJ XXV VII 148 në lidhje me Balotan. Më parë nga të gjithë Hahni (I 238) e pat afruar fjalën shqipe me emrin e *Shkodrës*-s e me *Codroipo-n* e Friulit; sh. edhe Diefenbach I 245.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që te Buzuku (LXXXI/2 = LXXXI/2, Efesët 2, 20): *ḡā atë të madh e të naltë ḡā r; katër kodrësh* «ipso summo angulari lapide»; Budi (RR 44v., SC 341) *Këjo sakrarie... grykënë ta kietë përsipëri nçelë, si e njaj tinari, o katër kodrë, sido të jëlë, e bukur mbuluom; venë trigjevet, e këtu e aty kuvendevet, e kodravet, ke u shkon dita nd asgjë e ndë të mbrazëtë*. Këto burime dëshmojnë për *kodër* një kuptim «kënd, qoshe», i cili është me rëndësi vendimtare për etimologjinë e fjalës; vendin e tekstit të Buzukut te Grigori e gjejmë *gur i qoshësë*. Një i tillë kuptim ka lënë gjurmë dhe në gjuhën e sotme; kështu në Gjirokastrë *kodër* quhet një vend ndërtuar me sofate që përbëjnë një qoshe, ku rrinin dikur pleqtë e mëhallës. Me këtë përdorim të fjalës që del tani në shesh, një spjegim i saj nga lat. *quadra* ose *quadrum* bëhet, mund të themi, i sigurtë, khs. dhe vrejtjet tona në Revue

de Linguistique VII 1 170. Vërtet se lat. *qua-* ka dhënë në shqipen më shumë *ka-* (sh. *kartë* e *kortë*, *kaçile*) e në rumanishten *pa-* (*patru*), po për shq. *kodër* rum. *codru* do menduar një ndrim *qua-* që në lat. vulgare ballkanike (*codra codrum*), prej së cilës e kanë ato dy gjuhë. Për ekzistencën e formave të tilla në latinitetin lindor, përveç *Codratus codra* etj. që u përmendën më sipër, dëshmon për mendimin tonë dhe gr. e vj. **κοδράνης** për lat. *quadrans* (te Schwyzer Gri. Gram. I 158), gr. e mesme **κοτρίγα** prej lat. *quadriga* (te Triandaphyllidis 126), e tani emri *Codrato* në Moesia inferior (H. Mihaescu, Limba latina in provincile dunarene ale imperului romin 99). Kështu mendimi i Schuchardt-it, Skokut e Brüchut gjen një vërtetim të ri nga ana e shqipes.

**kokë** f. «krye», me plot kompozite (shumica bahuvrihi), si *kokëdërr*, *kokëkungull*, *kokëmollë*; *kokësit* mpl. në Myzeqe «krerët, parësia e vendit». G. Meyeri 165 e bashkon me *kafkë* «rrashta e kresë», dhe që të dyja i nxjerr nga lat. vulgare *cauca coca* «kupë për të pirë», kjo prej gr. vulgare **καύκα** «patera» gr. e re **καυκί** «enë e baltë». Etimologjia gjer diku e drejtë: lat. *coccus* «kokërr, koqe», gjindet te Weigandi 37. Ashtu edhe Kretschmeri (Aus der Anomia), i cili e spiegon më drejt nga lat. *coccum* «bërthamë, kokërr», njëkohësisht duke tërhequr vëmendjen në këtë që Shqiptarët bien në sy për kryet e vogël që kanë.

Fjalë e mbarë gjuhës. Me kuptimin e kresë nuk dëshmohet lashtërisht: si autorët e vietër të Veriut si dialektet e kolonive për atë përdorim *krye* me variantet e saj. Me gjith'atë ky kuptim duhet të jetë saiuar miaft heret në shqipen, sa kohë që fjala ka shkuar dhe në dialektin meqenit të rumanishtes, si *coca* «krye», sh. për këtë fjalë Scriban, Arhiva (Jasi) XVI 129. Përdorimi i *kokë-s* ka qenë në të parë ekspresiv «kokërr». e prej këndeje «krye»: nga kjo anë ajo është e krahasueshme me zhvillimin që mori lat. *testa* nëpër gjuhët romane, për të cilin sh. Meyer-Lübke REW 8682. Shihet kështu që ky emër i kresë është një me *kokë* «kokërr, koqe» (peme, drithi, veje etj.) në Dibër, me *grunë kokrronë* «një lloj gruri» në Tiranë (te Manni: prej *kokërandë*); me *kokë cimarhës* «kokrra e një farë bime» në Piqeras të Bregut të Detit (M. Totoni), me *kok-a* pl. *koç* «grano, granello, chicco» në Borgo Errizzo (Tagliavini 149) e me *kókkatë* «ëmbëlsirat» që jep Kamarda (II 159) për arbërishten e Siqelisë. Identike m'anë tjetër edhe me *kok* m. «kokërr peme, pemë» të Kalabrisë, të cilën G. Meyeri më një tjetër vend (f. 194 v.) e bie të ardhur prej lat. *coccum*. Me këto të dhëna shihet se *kokë* me të dyja kuptimet, si me të kresë si me të kokrrës, është fjalë e mbarë gjuhës. Dy trajtave, *kok* e *kokë*, të shqipes u përgjigjet kryekrejt rumanishtja, me *coc* «bukë e vogël e rotullare» e *coca* «ëmbëlsirë»; për këto e për të tjerat reflekse romane të lat. *coccum* sh. Meyer-Lübke REW 2009. Në këto rrethana *kokë kok* mund të ketë rrjedhur dhe ajo prej lat. *coccum*, e cila dihet se vjen nga gr. **κόκκος** «kokërr, koqe, bërthamë»; këtë mendim do ta mbështeste edhe kjo, që lat. *coccum* ka dhënë në gjuhët romane disa kuptime që janë të afra me të shqipes, si, përveç «kokërr», ndër të tjerat edhe «krye, kokë», «kafkë», «tru», «ëmbëlsirë rotullare si vezake». Me gjith'atë, si një fjalë në thelb e sferës së bimëve e të frutarisë, *kokë kokë* (prej nga kanë buruar dhe *koqe, kokërr* etj.), mund të ketë ardhur drejtpërdrejt nga gr. e vj. **κόκκος**. Pra kjo hyn në ato fjalë të kulturës greko-latine që trajtojmë në Revue de Linguistique VII 1 182, për të cilat burimi i pandërmjëmë (grek apo latin) mbetet çështje e ha-

pët. — Kjo fjalë me domethënie e kokrrës është treguar poaq produktive sa edhe me atë të kresë. Prej saj kanë dalë disa forma më të vjetra, si plurali i singularizuar *koqe*, fjalë e mbarë gjuhës. Dialektore përkundraz (vetëm e geg. veriore) është *koke*, te Bashkimi e te Cordignano «kokërr», te Fjal. i gju. shqipe «sheqerkë». Atij dialekti i përket në thelb dhe deminutivi *kokërr kokër* (sh. këtë). Një tjetër deminutiv i *kokë-s*, ky formuar me *-lë -l*, është *kokël* f. «kokërr sheqeri, sheqerkë», «kokërr përgjithësisht», te Bashkimi «bubrek», te Tase 85 *koklë thëngjilli të ndezur, koklë prushi*; andej dhe denominativi *shkokloj (sh-kokloj)* «shkoq». Sigurisht më e vjetër është *kokëzë*, të cilën e dëshmon dhe Pekmezi 224 shën. 1. Ajo ka shkuar dhe në rumanishten, si *coacaza* «Ribes grossularia. rrush frengu». sh. Densusianu Romania XXXIII 74. Meyer-Lübke REW 2009, Rosetti Ist. li. rom. II<sup>3</sup> 100, 101, 112. Për këtë nuk do nisur nga një *koqezë koqezë* e shqipes (Densusianu; Puscariu Limba româna I 265), po. siç na mëson Jokli (IJ XI VII 192, kundra Pascut), nga *kokë* «kokërr, koqe» + *-zë*; sh. dhe Li. Posn. VIII 95v. Pra *kok, kokë, kokël, kokërr e koqe* janë degëzimet e një fjale të vetme, e jo fjalë burimesh së ndryshme.

**kokërr, kokër** f. «koqe drithi a peme, koqiskë». Këtë fjalë G. Meyeri 19 e Helbigu 57 e spiegojnë nga it. *coccola* «kokërr», Tagliavini 149 — me sa duket — drejtpërdrejt nga lat. *cocum*. Jokli (Archivum Romanicum XXIV 29) sheh aty me të drejtë një deminutiv me sufiks *-ër(r)*, khs. dhe Xhuvani-Çabej Prapashtesat 42.

Fjalë e geg. veriore, që sot ka marrë rrugën e përgjithësimin në gjuhë, duke zëvendësuar kudo fjalën *koqe* (sh. këtë). Këtë rrugë ka marrë dhe deminutivi i saj *kokërrizë* «kokërr e imët», edhe si mbiemër e ndajfolje, *borrë kokërrizë*; kjo morfologjikisht nga një *\*kókërrëzë*, me shpërngulje të rregullt të akcentit në silabë të parafundit. Nga *kokërr* edhe mbiemrat kompozitë *kokërrmadh* «koqemadh» (*rrush kokërrmadh*) e *kokërrvogël* «koqevogël» (*ulli kokërrvogël*), si edhe verbi *me kokërrue* «me mbledhë kokërr për kokërr», *m'u kokërrue* «m'u përmbledhë në vetëvedi, m'u vetmue» te Gazulli, te Fjal. i gju. shqipe *u kokërruen krushqit* «u ndanë e u vunë varg»; te Gazulli edhe *kokërrduçe* f. «kokërra qi shkaktonte një farë mize ndër lisa, gogël, gjerm. Gallapfel». Edhe nga *kokërrizë* është formuar një verb, *kokërrizoj kokërrizohem*. Një tjetër rrjedhojë e *kokërr-s* është *kakërruk* m. «çdo pemë me bërthamë, si kumbulla, pjeshka etj.; arrë e fortë». G. Meyeri 195 e gjen këtë te Bardhi si *kakërruk* «arrë», dhe e spiegon si një kompozit të *kokërr-s* me serbokr. *orah* «arrë». Nuk është veçse një zgjerim i *kokërr-s* me *-uk*, si të thuash «kokërr e vogël», sh. për *-uk* Xhuvani-Çabej Prapashtesat 99. Është një fjalë e geg. veriperëndimore, ku vihet re hapja e *o-së* në *a* në pozicion para theksit. Ndërkaq ruhet dhe trajta *kokërruk* nëpër dialekte, ku si e tillë, ku ndryshuar në *kukërrukë*, sh. Mannin. — Për spjegimin etimologjik të *kokërr-s* më fort se prej *koke-ja* «nji si me thanë: kokërr» te Bashkimi e te Cordignano (Jokli) si primitivi i saj, do nisur nga *kokë-a* me kuptimin e kokërrës që ka kjo në disa dialekte të shqipes (sh. *kokë*), khs. Li. Posn. VIII 95. Të dyja fjalët pihen dhe në përdorim të tyre. Kështu shprehjes një *kokërr mollë* në Dibër i përgjigjet një *kokë mollë*; e shprehjeve një *kokërr dele*, një *kokërr dhi* të Junggut e Bashkimit u përgjigjet prej Toskërie njëzet *kokë dele*, nj. k. dhi.

**kolash** m. «kaçamak, mëmëligë». E ka Fjal. i gjuh. shqipe. Përdoret

në Elbasan për kaçamakun që gatuhet me vaj. Huazim krahinor nga bullg. *kulasa* «një lloj qulli». Fjala sllave, që gjindet në shumë gjuhë të këtij grupi, është etimologjikisht e errët, sh. Berneker I 642, Vasmer REW I 688.

**kom** m., **komë** f. «jele e kalit». E jep Kristoforidhi për Tiranë. G. Meyeri 196 shënon pas Mitkos një emër *komtë komëtë* m. «pëlhurë me qime cjapi siç janë thasët» dhe e lë pa spjegim etimologjik. Jokli (Studien 110) këtë emër bashkë me mbiemrin *i komtë* në *sitë e komtë* «sitë me qime (kali)» e gjykon drejt si një mbiemër me sufiks *-të* dhe sheh aty një huazim nga lat. *coma* «flokë, jele; gjethe drurësh». Për Baricën (I 40v.) *komë* nga një bazë \*(s)kēpn- është fjalë vendi e shqipes, e afër me pers. e re *capis* «ftujak», gjerm. *Schaf* «dele».

Spiegimi i Baricit, i cili nisët nga një kuptim i paramenduar «lëkurë cjadi» e shkon gjër te një më i tejtmë «ciao», kuptime që nuk gënden gjëkund, është edhe semantikisht i pamundur, pa folur për vështirësitë formale që i dalin përpara. Etimologjia latine sigurohet me *komë komë* «jele» te Kristoforidhi, e cila bashkë me rum. *coama* «jele» dëshmon për ekzistencën e fjalës në latinishten ballkanike. Në shqipen kjo ka marrë një përdorim më të hapët. Adjektivi *i komtë* del që te Budi (SC 54 *ndë një thes të komtë*) dhe mbi dëshminë edhe të Mitkos e të Kristoforidhit vërtetohet si një fjalë e mbarë gjuhës. Gazulli dëshmon për Pukë *komë* «fije floku, qime», *koma e kalit* «kika, kripi i kalit», e adjektivin e substantivuar *komtë* (*i bamë me komtë*) që piqet me *komtë-n* e Mitkos. Një zgjerim me sufiksën *-z* është *komëz-t* pl. «krimba që përftohen në zorrët e deleve» te Bashkimi. Sh. për këtë Li. Posn. VIII 108v. Për krejt fjalën e format e saj khs. dhe Revue de Linguistique VII 1 196v.

**koqe** f. «kokërr (drithi, peme, veje e çdo sendi të rumbullaktë); puçërr»; *koqet* pl. «herdhet»; *shkoq* «shkokloj, i heq kokrrat»; *përshkoq* «shpëndaj, përhap»; neologjizëm *shkoqit* «spiejoj me hollësi». Që nga Schuchardt (KZ 20, 49) dhe G. Meyeri (f. 194v., 210) e këtej e spiegojnë prej një lat. \**coceum* si zgjerim i *coctum*, duke nxjerrë prej kësaj dy fjalë të ndryshme të shqipes, si *koqe* si *i kuq*. Ashtu edhe Skoku (Z. f. rom. Phil. 48, 398vv.), Walde-Hofmann I 241, khs. dhe Tagliavinin 149.

Fjalë e mbarë gjuhës, e cila del që te Buzuku (LXIII, Gjoni 12, 24; LXXXVII/2 = LXXXXVII/2, Proverbet 31, 10): *koqeja grunë qi anshtë mbjellë ndo di e ajo në mos kloftë bdjerë* «nisi granum frumenti cadens in terram mortuum fuerit»; *njemend me koqet të margalitarit anshtë të vijyemitë e saj* *τιμωτέρα δέ εστιν λίθων πολυτελών ή τοιαύτη*, Budi (SC 86) *një koqe voe*. Këto përdorime janë ballkanike, që pas Sandfeldit 160v. kanë dalë nga ndikimi i turqishtes. Në gegërishten sot, për punë të përdorimit obscen që ka marrë, *koqe* është zbrapsur mjaft në përdorim të saj. Kjo vihet re tani dhe në toskërishten, ku me përzjerjen e dialekteve ka nisur të depërtojë geg. *kokërr*. Për produktivitetin e fjalës në toskërishten dëshmojnë ndërkaq *koqëz koqkë* «puçërr», *koqërina* pl. «koqka të vogla që dalin në trup», *koqina* pl. «të lashta» (*kemi mbjellë shumë koqina sivjet*), *koqile* (e vogël sa një *koqile* S. R. Dine). Në thelb një deminutiv i *koqëzë-s* me *-kë-* ashtu siç është *koqkë* i *koqe-s* — është *koqiskë* «kokërr, koqe e vogël» (e pemës, e drithit etj.), formuar me *-iskë*, si *baliskë lariskë murriskë*; ky formant është një konglutinat *-ëz-kë* me shpërngulje të theksit në silabën parafundore e me asimilim të *z-së*

ndaj *k-së*, khs. dhe Xhuvani-Çabej Prapashtesat 59; formantikisht *koqis-kë* paraqitet kështu e pajisur me sufiks të dyfishtë. — Spiegimi nga një lat. \**coceum*, e cila nuk çfaqet gjëkund as në botën romane, do lënë mënjane. *Koqe* nuk është veçse një trajtë e fjalës *kokë*, që sot ka marrë përgjithësisht kuptimin e kresë, po që nëpër dialekte brenda e jashtë Shqipërisë ruan ende domethënien «kokërr peme»; *koqe* pra semantikisht shkon me *kokëzë*, *kokël* e *kokërr kokër*, që edhe duke qenë deminutive të *kokë-s*, sot largohen prej saj në punë të kuptimit. Morfologjikisht *koqe* u ka formuar nga trajta mashkullore e *kokë-s*, nga *kok*, me anë të singularizimit të pluralit: *kok* në plural *koqe*, kjo doli më vete si femërore e re *koqe-ja*, sh. Li Posn. VIII 95. Prandaj për etimologjinë e saj sh. te *kokë*. Afërinë e *koqe-s* me kal. *kok* e vuri re dhe Kamarda I 112. — Ky singularizim plurali është mjaft i vjetër: më një anë e ka Buzuku me Budin, më tjetër anë arbërishtja e Kalabrisë (*Mirrëjën koqet e dhrisë bardhë* «Prendevano gli acini della vite bianca» Kamarda II 112); më anë tjetër edhe dialekti i ishullit Poros në Greqi ka *koqëzë* «puçërr», nga një *koqëzë* që *nxuar ndë buzë*, të cilën Weigandi (Balkan-Archiv II 196) gabimisht e jep me «an Ciner Beere, die sie in die Lippen nahm». Kjo *koqëzë*, e cila del dhe në bianca». Kamarda II 112); më anë tjetër edhe dialekti i ishullit Poros në Greqi ka *koqëzë* «puçërr», nga një *koqëzë* që *nxuar ndë buzë*, të cilën Weigandi (Ballkan-Archiv II 196) gabimisht e jep me «an einer Beere, die sie in Lippen nahm». Kjo *koqëzë*, e cila del dhe në Shqipëri si *koqezë*, morfologjikisht është e krahasueshme me deminutivin *kokëzë* të *kokë-s*, formim më i vjetër që ka shkuar dhe në rumanishten si *coacaza*. — *Koqe* pl. «një lloj gjellë a ëmbëlsirë me grurë të zier, sheqer, arra të thyera etj., që gatuhet e ndahet në të kremte, në përshpirtje o në të tjera raste» piqet në kuptim me sllav. e vj. kish-tare *kucija* rus. *kut'ja* etj. me të njëjtin kuptim të cilën e spiegojnë prej gr. së re e të mesme *κουκιά* pl. *κουκιά* «faba», sh. Berneker I 654, Vasmer REW I 707. Kemi të bëjmë me një zakon të kishës bizantine, i gjallë edhe sot në popullsitë ballkanike të rritit grek-ortodoks. Me atë kuptim përdoret gr. e re. *κουκιά*.

**korán** m. «Salmo letnica, lloj trofte me pika të kuqe, e liqenit të Ohrit». E shënon sëpari Hahni, Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar 100. Mendimin e Stierit (Nr. 152) që të ketë lidhje me emrin e *kuran-it*, e kundërshton me të drejtë G. Meyeri 199, po vetë e lë fjalën pa spjegim. Si shumica e emrave të peshqve në liqen të Ohrit si *bellicë belushkë*, *lenicë* etj., edhe emri krahinor *korán* vjen prej bullgarishtes: *koranъ*. Këtë Mladenovi 251 e lidh me *kora* «koje».

**koríth, korríth** m. dhe si mbiemër *rrush kor(r)íth* «lloj rrush mustet». Nga emri i qytetit *Korinth*, në shqipen e Greqisë (Reinholdi 17) *Korith*; edhe në greq. e re *κορίθι* «lloj rrushi», te Andriotis 108. Një tjetër lloj rrushi që kujton Greqinë është *gërqinjë e bardhë*, *gërqinjë e zezë*. Forma e Korçës *koridhe* f. rrjedh nga singularizimi i pluralit, Li. Posn. VIII 89.

**korqe** f. «kore, lëvezhgë, lëkurë», fjalë e shqipes së Kalabrisë. Pas G. Meyeri 200 nga lat. *corticem*; pokështu edhe Bartoli (Italia e Croazia 153) e Manni 210.

Nuk është gjë tjetër veçse it. jugore e Kalabrisë *corchia* «lëvezhgë, guall» (p.sh. e vesë, pemëve etj.) që e ka Rohlfsi, Diz. dial. delle tre Calabrie 225.

**korsëm** «gjoja, kinse». Këtë fjalë e jep Hahni për të dy dialektet.

Kristoforidhi ka për toskërishten *korsëm*, për Tiranë *korrese*. Në Elbasan dëgjohet *korsëm* në gjuhën e grave. G. Meyeri 200 e lë pa spjegim. Mendimi i Baricit (I 89) që *korsëm* të jetë \**kos-rëm* e që \**kosë* të reflektojë një bazë \**kūā*-*h-ue* me përemrin *kūi* «kush», është i padiskutueshëm.

Te Bageri (f. 27, 42) gjindet dhe *ky korse të ruhet prej mizës; ... shkon ... në kopësht, korse të mshehine dhe gjysmën e t'hollavet*. Është *kor se* = *kur se*, shkurtim i *sikur se*, me *kor* «kur» të geg. lindore. Është një nga ato fjalët e shqipes që kanë dalë nga bashkimi i dy (a më shumë) fjalëve në sandhi, si *shklata*, *pondë*; me *se kinse, druse*. Në Shqipëri të mesme ka hyrë nga geg. lindore.

**kortë f.** *nji kort mish* «një këmbë mish, një çerek mishi». Fjalë e Elbasanit, e përegjistruar gjer sot. Duhet të jetë një me *kortë* f. «masë 40 okësh për lëngje» që ka Bashkimi e më tej me *kortarë* mpl. «duar e këmbë këputur nga trupi», *kortarë-kortarë* «copa-copa», bashkë me verbin përkatës *m'u kortarë* «rimanere sfinito dalla fatica, stanchezza, malattia, ecc.» po te Bashkimi. Nuk ka dyshim se kemi të bëjmë me një refleks të lat. *quartus*. Me këtë fjala është një me *kartë* II nga lat. *quarta*. Mbetet ndërkaq e pazgjidhur pse e njëjta fjalë latine dha në shqipen dy reflekse fonetike të ndryshme. Nga këto, *kortë* paraqet poatë ndrim të lat. *qua-* në *ko-* si *kodër*, ndërsa *kartë* shkon me *kaçile*. *Kortarë* është një formim i brendshëm i *kortë-s*, jo lat. *quartarius*. Këtë e dëfton dhe ruajtja e pandryshuar e *o-së* në trup fjale. Forma *koftar* për *kortar* ka dalë nga një ndikim i *kofshë-s*.

**korube, kurube f.** «zgjua blete». Për G. Meyerin 170 është një me *kolibe* «kasolle». Me më të drejtë Selisçevi 167 e spiegon nga bullg. *koruba* «dru zgavër, zgavër druri».

Kjo etimologji bullgare përlijet dhe me rrethanat e gjeografisë dialektore, sepse fjala është e toskërishtes. Ndërkaq dhe *kolibe* ka ndikuar në këtë mes: nga një kryqëzim i *korube-s* me *kolibe* ka dalë *kolube*, e cila bashkon në vetvete të dy kuptimet, «kolibe, kasolle» dhe «zgjua blete, korube». — Burimi i slav. *koruba* ka mbetur i pasqaruar. Bernikeri I 577 e quan fjalë të errët. Mendimi i Mladenovit (f. 252) e i Vasmerit (REW I 439) që e lidhin me sllav. *kora* «kore, lëkurë», me gjithë se është pranuar dhe te J. Hubschmid (Praeromanica 104), nuk bind. Pas mendimit tonë *koruba* vjen nga gr. *κουρούπιον* «enë e thyer, garraç» gr. e re *κουρούπα κουρούπι* «saksi lulesh, enë»; kjo ka hyrë dhe në gjuhën shqipe, si *korupë kurupe e gurupi*, sh. këto fjalë. Edhe në të tjera gjuhë zgjoi i bletës e ka marrë emrin prej ndonjë ene. Khs. prej gjuhëve romane piem. monf. *bui d'avie*, Nievre *buyo* «zgjua» nga *bolium* «enë», it. toskan. *cupile* venec. *koveqa* etj. nga lat. *cūpa* «gaviç, kade», it. kal. *kupieddu* nga lat. *cūpella*, trent. tiçin. *vas d'avic* valenc. *vaso* nga *vas* «enë», it. sic. *vasedda* *vaseddu* nga *vascellum*, REW 1193, 2401, 2402, 9161, 9163. Këto lloj emërtime shpesh rrjedhin nga përdorimi i enëve të ndryshme, kadeve, fuçive etj. si zgjoj bletësh. Po nganjëherë emrat e enëve të thyera e të garraçave kanë arritur në kuptimin e përgjithshëm të zgavrës, drurit zgavër, zgarbullës (sh. *korupë*), e s'andejmi u kalua te «zgjua blete».

**koshëz f.** «Oestrus, insekt i rendit të dipterëve, që rron nën lëkurën e gjësë së gjallë, vongorec». Mungon te G. Meyeri. E ka Kristoforidhi për Gegëri me kuptimin e gr. së re *γούβρος*; pas tij dhe Bashkimi. Gazulli e dëshmon për gjerm. «Rindsbissfliege» si dhe për mullërin ku fshi-

het kjo mizë, gjerm. «Dasselbeulen». Fj. i gj. shqipe e shënon si *koshas* mpl. Nga lat. *cossus* «krimb i drurit; krimb i zorrëve», që rron ndër të tjera dhe në rum. *cos*, khs. Bogrea (Grai si Suflet II 422vv.), Candrea poaty III 430. Për zgjerimin me -zë Jokl IJ XIV VII 123. Për përhapjen e fjalës latine në gjuhët romane Meyer-Lübke REW 2278.

**kothóm** m. «themeli i shtëpisë; plang, katandi». Pas Xhuvanit (Kopështi letrar II 14) nga gr. *κόθωμα* «ulem, rri; banoj».

Nga gr. e re *κούρωμα* «pjesa e zbrazët e murit pranë derës a dritares» që e ka p.sh. Dimitrakos V 4096. Kështu kjo fjalë është një me *kufomë*. Veçse paraqet ndrimin e spiranteve *f:th*, ndrim i shpeshtë në gjuhën shqipe.

**kraharór krahnúer** m. «gjoks, parzëm; gj, sisë». G. Meyeri 203 (para tij Kamarda II 66) e bashkon me *krah*. Pas Wiedemannit (Bezenbergers Beiträge XXVII 250) e Weigandit (f. 39. Alb. Gram. 55) nga *krahën krëher*, duke u nisur këta nga ideja e **brinjëve** që paraqiten fije-fije si krëhër. Ky mendim të cilin e kishte dhe Kristoforiani 176, pëlqehet dhe te Jokli LKU 154.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del që Buzuku (LXXVI = LXXXVI, Luka 18, 13): *por rih krahënuorë e ti* «sed percutiebat pectus suum», krahas me tjetrin emër të kësaj pjese të trupit, *parmëza* «parzëm». Budi (DC 155, 188, SC 22, 166) *krahanuor*, *krahanorit*. Bardhi i Pectus *Krahanuer*, *Pectorosus Krahanuens* (gabim shtypi?). Bogdani (I 66, 17) *nxierë prej krahënorit së Krishtit* «tolta dal lato di Christo». Si e kemi shënuar dhe te Bul. i Shk. Shoq. 2 (1954) 44, i drejtë mbetet vetëm afrimi me *krah*. Nga pikëpamja e formës do vrejtur se një zgjerim i *krëhër-it* do të kish dhënë tosk. \**krëhëruar*, jo *krahëruar kraharuar*; edhe geg. *krahanuer* me -a-në e tij të dytën spiegotet më lehtë prej *krah-ut* se prej *krahën-it*. Për kuptimin është për të vënë re se fjala te Bogdani përdoret për it. *lato*; kështu domethënia e kësaj duket të ketë qenë më e gjërë se e *parmëzë-s*. Morfologjikisht *krahënuer kraheror* është një zgjerim me -uor (-uer -uar) prej pluralit më -ën -ër: a prej dy kraheve të duarve, a -ka më të gjarë- prej *krahë-ve* me kuptimin e shpinës. Një i tillë kuptim më i hapët i *krah-ut* del dhe nga *krahol* «ielek», *kraca-t* pl. «ornati del jelek» (Junggu. Bashkimi). *krahës* «këmishë». *krahnorse* «trastë», *krahosh* «traisë që mbainë ushtarët e turistët në krahë», *krahnoç* «krahosh ku barinjtë vënë bukën e tyre». Në toskërishten sot fjala ndihet *krahëruor kraharor*, po ruhet nëpër dialekte e në poezinë popullore dhe forma e vjetër më -uar (*Mete Duka gjakëcuar Ç'u lavos në kraharuar*).

**kreher krëher krahën** m. «vegël për të krehur; krehër i tezgjahut; gërhanë, shutër; skelet i peshkut». Lidhet, sikundër dihet, me *kreh*. Te verbi vihet re që te Budi labializimi i *h-së* në *f* në gegërishten, te emri ruhet *h-ja* edhe sot; sh. Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Ser. Shk. Shoq. 1 (1958) 74. Një çështje përbën morfologjia e fjalës. Do të pranohet me G. Meyerin (Alb. Studien I 55) që *kreher krahën* është formuar me sufiks-in -ën -ër, si *dimën dimër*. Një tjetër pyetje është ajo e vokalit të brendshëm: *kreher krëher krahën*, përkundrajt *e-së* së verbit. G. Meyeri 204 -ë-në te *krëher* e bie të dalë në fillim në silabë të pathekse. Kjo nuk spiegon formën *krahën* të gegërishtes. Pas mendimit tonë *krahën* ruan vokalizmin origjinal të fjalës, verbi *kreh* e ka ndruar atë me anë të metafonisë. Tosk. *krëher* do të jetë formuar analogjikisht pas geg. *krahën*; *kreher* e ka e-në prej verbit. Theksimi *kërhënë kërhërë* që vuri re Jokli (LKU

156v.) në shumë burime, pas mendimit tonë ka ndodhur në shumë, ku është i rregullt. Me singularizim të pluralit ky theksim çoi në formim të *gërhanë-s* (sh. këtë fjalë).

**krejt** «fare, kryekëput; tërë, gjithë». Fjalë e dëshmuar vonë, që mungon te G. Meyeri, po që me gjith'atë duket të jetë me burim popullor. Është gjindore-dhanorja e shquar e emrit *krye* (i *kreit*, *kreit*) që u bë adverb, sh. Pekmezi 252. Për kuptimin khs. rus. *soversenno* «krejt, fare»: *verh* «majë, krye». Forma *kejët* «shumë» te M. Sirdani HD VI 161, te Manni i *zemruem kejet*, është ablativi i *kre-së* (trajta femërore e *krye*) me humbje të *-r-së* në trup fjale; poashtu si te *kezë* (sh. këtë fjalë) e te *përkiet* «sipër» në Dibër = *për kriet*.

**krepull** «dehur, plasur së ngrëni e së piri». Del vetëm te Budi (SC 132, 134, 396, RR 214), bashkë me verbin *krepullohem*: *ō aqë ngran e jīm mbramanet pakuor, sã nesëret kie qenë gjithë krepullë, e randë, e sikūr e ejm e pa mend; ō krepullë e turbulluom mendje e shqiseje vene cë mbramjesë, verbi aqi n cë krepulluomi e venet cë pākōrë; e jo pīm e krepulluom*. Është një nga ato fjalë, për të cilat s'mund të thuhet me siguri a rrjedhin prej latinishtes a prej italishtes. Lat. *crapula* «të qenët dejhëm; recina që i shtihet verës; të ngrënë e të pirë pa kuar» do të shkonte mirë për nga ana e sufiksit, po jo për vokalin e brendshëm; për një metaforë *a*: e është vështirë të mendohet te një emër që s'ka plural. It. *crepare* «me plasë» spiegon mirë vokalin e brendshëm, po jo aq mirë kuptimin.

**kreshnik** m. «trim i rapsodive të ciklit rreth Mujit e Halilit», që quhen *kangë kreshnikësh*. Sot përgjithësisht «trim, hero», edhe si mbiemër: *armët kreshnike*. Fjalë e geg. veriore, që s'e ka G. Meyeri. Spiegimi i drejtë është ai nga serbokr. *kraesnik* «trim», prej *krajina* «krahinë kufitare», që jep A. Schmaussi (Prilozi proucav. nar. poez. 1, 1934, 107vv., përkthyer te Leka VI 249vv.). Edhe vetë këto këngë trimash quhen në Kosovë, pas Schmaussit, *kraina* (me laut), serbokr. *krajisnica*; pas Murkos (Prilozi 18, 565vv.) në Vuçitern *krajine*. Bie spiegimi nga \**kresh(t)nik* prej *kreshtë* te Jokli (Balkangerm. u. German. im Albanischen 116), që e kemi dhe ne HD XV 163v., Vierteljahrsschrift für Südosteuropa 3, Nr. 3 (1939) 240 v. shën. 35; poashtu dhe ai nga sllav. *krst* «kryq», duke e lidhur emrin me kryqëzatat. Spiegimin e Schmaussit e pranon Jokli (IJ XXIII VII 199). Poashtu Lambertzi (Die Volksepik der Albaner 243), i cili për formimin e fjalës sjell për krahasim gr. bizantine ἀκρίτης «kufitar» e «trim».

**krezm** m. «vaji i shenjtë i ceremonive fetare katolike, miro»; *krezmoj* «lyej me krezm, miros»; *krezmim* m. Për këtë fjalë G. Meyeri më parë (f. 206) mendonte një burim nga serbokr. *krizma* «krezm» *krizmati* «me krezmue»; po më vonë (Alb. Studien IV 124), përballë formës *kresmoj* të Kavaliotit, anon më fort nga lat. *c(h)rismare*. Helbigu 77 *krezmoj* e spiegon nga it. *cresimare*.

Në literaturën e vjetër të Veriut paraqitet me dy trajta. Buzuku (XXV/2b) ka e *aj tīj të leftë me shenjtët krizmë*; Budi kudo (RR 13, 25, 44, 261, 358, SC 118, 395 e në pasqyrën dëftonjëse të kësaj vepre) *krezm, të krezmuomitë, n cë krezmuomit*. Pas gjase kemi të bëjmë me huazime burimesh e kohësh së ndryshme. Verbi *krezmoj* është një formim i brendshëm, një denominativ i *krezm-it*. Për këtë përjashtohet një burim sllav, si për punë të fonetikës si për arsye historike, sepse nuk ka huazime sllave në kishën katolike shqiptare. *krezm* pas gjithë

gjasësh rrjedh nga it. *cresima*; kjo ka shkuar dhe në greq. të re si  $\kappa\rho\epsilon\zeta\iota\mu\alpha$   $\kappa\rho\epsilon\zeta\iota\mu\acute{\alpha}\rho\omega$ , G. Meyer Ngri. Studien IV 41. E një periode më të vjetër gjan të jetë *krizma* e Buzukut. Për këtë për arsyen historike që u tha më sipër përjashtohet si burim serbokr. *krizma*; në vështrim vijnë lat. *chrisma* e gr. (bizantine)  $\chi\rho\iota\sigma\mu\alpha$ , e cila ka hyrë dhe në gjuhët sllave (sh. Berneker I 402v.). Për Verium katolik të Shqipërisë ka më të gjarë burimi latin, po nuk përjashtohet edhe greqishtja, khs. *bagëm*. — *krezmim* është një formim më i vonë, formim i brendshëm ashtu si *krezmoj*.

**krifshë** f. «Phillyrea media, mret». Mungon te G. Meyerit. Del sëpari si *krish* m. te Junggu e *krishë* te Bashkimi, me spjegimin e pasaktë «bush». Fjal. i gju. shqipe *krifshë* f. *kripç* m. e *grifshë* f. «Phillyrea media». Mitrushi 487 jep dhe *kripç* (Luarsi i Shkodrës), *kripshë* (Leshi), *grishë* (Puka), *krefshë* (Miloti), *gribçë* (Ishmi), *gribëshë* *gribshë* (Kavaja). Gazulli përveç *krifshë* ka për Veri edhe *kripëç* *kripçë* *krishë* *grishë*, po me kuptimin «ullastër, Olea oleaster». Nga këto trajta dialektore, ato me *-sh-* të thjeshtë (*krish*, *krishë*, *grishë*) janë të geg. veriore, ku është kryer asimilimi i grupit *fsh* në *sh*, sh. Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Serbia Shk. Shoq. I (1958) 69v. Trajta *krefshë* e Milotit paraqet hapjen e *i-së* në *e* të disa dialekteve qendrore të Gegërisë (Mirditë, Mat, Lurë etj.) Një përhapje më të madhe kanë trajtat me *gr-* (*grifshë*, *grishë*, *gribçë*, *gribëshë* *gribshë*, në Vlorë pas Mannit *grifshël*, në Kërrabë pas M. Çelikut *grifsh* m., po *grifsh-a* f. emër i një bime të egër). Këto kanë dalë nga sonorizimi i shpeshtë i *k-së* në ballë të fjalës, sidomos pranë një likuide (sh. *gëlqere*, *gërbulë*, *gërshtë* etj.), gjë që ka lidhje me mënyrën e artikulimit të okluzivevet në gjuhën shqipe.

Sikundër u shtjellua dhe më lart (te *grifshë*), *krifshë* me variantet e saj, si emri i një druri gjetheshumë, etimologjikisht është një me *grifshë* *grishë* *grizhlemzë* «Garrulus glandarius» e me *grizhël* «laraskë». Tertium comparationis dhe elementi emërtues është në këtë mes karakteri tufshak; te zogu *grifshë* pupëza që ka mbi krye; te druri gjethet e dendura të tij. prandaj këtij në Xibrakë të Elbasanit pas Mitrushit i thonë *gjethimë*. Përsa i përket burimit të mëtejme të këtyre fjalëve, fakti që si për drurin si për zogun ka dhe emra me *-p-* në vend të *-f-së* (druri edhe *kripçë* *kripëç* *kripç* *kripshë*, me *-b-* *gribçë* *gribëshë* *gribshë*, zogu edhe *gripshë*), është një shenjë që gurra është më fort *krip* «flokë, leshra» se *krife* «jele e kalit». Atëhere me këtë emër druri piqen edhe këto emra bimësh: *kripç* e *kripth* m. «specie di asparago selvatico» (Bashkimi), te Gazulli *kripç* «Festuca ovina», *kripth* «Loranthus europaeus», te Mitrushi 446 *kripç* *kripth* «Viscum album, vjeshtull» te Fjal. i gju. shqipe *skrips* «fije bari ndër ujëra», me prefiks *s-*. Nga këto, *kripth* është në thelb identik me *kripth* «gangrenë» (Fjal. i gju. shqipe), e cila quhet edhe *qime* (= *qime* fije floku), te Cordignano *kripth* «mallattia per cui escon tumori, foruncoli ecc.; reumatismo» (?). Në këtë grup fjalësh hyn edhe *krypësht* «Alyssum maritimum», sh. këtë fjalë.

**krua** **krue** m. Fjalë me burim të diskutuar. Pas G. Meyerit (Bezzenbergers Beiträge VIII 185, EW 207, Alb. Studien I 57, III 4, 67), si refleks i një baze \**krōn-* nga një më e vjetër \**krān-*, fjalë e afër me gr.  $\kappa\rho\eta\eta\nu$  dor.  $\kappa\rho\acute{\alpha}\nu\alpha$  lesb.  $\kappa\rho\acute{\alpha}\nu\nu\alpha$  «krua»,  $\kappa\rho\omicron\nu\nu\acute{o}\varsigma$  «shkulm, suvalë». Këtë afrim etimologjik — sëpari e ka Kamarda I 50, pas tij Dozoni 37 — e kanë miratuar shumë dijetarë, duke përfshirë disa dhe isl. e vj. *hronn* «valë», khs. Torp IF 5, 204, Peterson IF 24, 48v. Të tjera

krahasime te Diefenbachu I 52. Pas Thumbit (IF 26, 13v.) kemi të bëjmë me një huazim të shqipes nga gr. e vj. **κράνα** ose **κρήνη**, marrë në periodën pararomake. Mendim i pranuar te Boisacq 515 e te Walde-Pokorny I 488. Jokli (IF 37, 92) e ndan fjalën e shqipes prej asaj së greqishtes, dhe duke e analizuar në *k-rua*, e afron përbrenda shqipes me *përrua*, dhe si refleks të një baze \**k(ë)-rēn-* e shpie te rrënja indoeur. \**r n-* «rrjedh», duke e krahasuar me gjerm. *rennen rinnen* «me rrjedhë», sllav. e vj. kishtare (*iz*)*roniti* «effundere» etj. Mendim i kundërshtuar te Vasmeri (Studien I 50v., sh. dhe REW I 535) e te Walde-Pokorny I 139. Bariçi (I 81v.) mendon për një afëri të fjalës *krua* me *krye*, sh. dhe Arhiv za arb. starinu II 387. Te mendimi i Thumbit kthehet Ribezzo (Riv. d'Albania II 137 shën. 3). Fjala greke edhe ajo nuk është sqaruar për nga ana e burimit, sh. Schwyzer I 190. H. Lamer (IF 48, 228v.) e merr për një fjalë paragreke, të burimit «eøjeik». E errët për Hofmannin GEW 160.

Fjalë e gjuhës mbarë, e cila ruhet dhe tek emri i qytetit *Kruce*, në shekull të IX. peshkopata e **Κροών**, sh. Sufflav, Städte und Burgen Albaniens 18, Acta Albaniae I 48, 57. Plurali *kronj kronje* dëshmon për një singular të dikurshëm *kron*. Ky plural te Budi (DC 97) është *kroene*,

khs. *bri*, pl. *briena*, sot *Kroenëzat* pranë Reçit në Malsi të madhe (Marlekaj, Quaderni V 51v.). — Për etimologjinë do thënë se është vështirë, rënd të themi e pamundur, që të shkëputet fjala shqipe nga grekja, vetëm se (sh. dhe Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4, 1962, 131) nuk mund të caktohet më mirë lloji i raportit historik që ekziston midis dy fjalëve. Kuptimi i parë mund të jetë «dal, rrjedh»; khs. shq. *kryej krej*, gr. **ὄθεν ὁ Ἀχελῷον ἐκρέων** «nga del lumi Akeloon» te Aristoteli Meteor. I 352 a 27. Po edhe një lidhje e fjalës me *krye* ose me gr. **κρανίον** «rrashtë» nuk na duket e pamundur. Gjithsesi pra mund të kemi të bëjmë me një fjalë të burimit indoeuropian. Ndërkaq spjegimi i saj nga një trajtë bazë \**kë-rua* fonetikiisht nuk duket i drejtë, se *kë-ja* nistore do t'u kish ruajtur, khs. *kërrabë*, *kërrutë*; del përveç asaj edhe pyetja pse te *përrua* u ruajt *-ë-ja* e te *krua* jo. Pra fjala ka nisur qëmoti me *kr-*, ashtu si dhe në greqishten.

**krunde** fpl. «hime»; edhe figurshëm «për një njeri pa vlerë, që s'di gjë (p.sh. për një nxënës); për petka a këpucë grisur e bërë copë-copë». Që prej G. Meyerit (f. 132v., Alb. Studien III 8) e këtë marrin varianten *grundë* si primare dhe kështu e afrojnë këtë fjalë me gjerm. e ulët *grand* «krunde të grynja, zall» ags. *grindan* angl. *grind* «me thërmue, me fërrue, me blue». Vështirësia e vokalizmit që vë në pah G. Meyerit, pas Joklit (Studien 25) zgjidhet duke vënë për bazë një \**ghrūd-*, ku nazali sonantik dha *-un*. Etimologji e pranuar me këtë formë te Walde-Pokorny I 656, Walde-Hofmann I 545, Pokorny I 459, Hofmann GEW 421. Khs. edhe Bariçi I 40, Vasmer Studien I 40, Tagliavini 160 me literaturë. Përkundrazi Treimeri (Mitt. d. Rum. Inst. Wien I 358) nisat nga *krunde*, dhe këtë e afron me sllav. e vj. kishtare *krupa* «thërrime, thërmiqë». Për Giuglean mënfund (Dacoromania III 596vv.) rum. *grunz* «grumbull, tok; kokërr kripe» rrjedh prej gr. **χόνδρος** «kokërr (kripe, kemi), bullgur», e shq. *krunde* bashkë me arom. *grunda* «grumbull, tok» e *grindza* pl. *grindze* «krunde» burojnë prej një gr. \***χονδρίον** «si bullgur». Kundra kësaj etimologjie Jokli (IJ XI VII 138) vë re me të drejtë se një e tillë bazë greke as është e dokumentuar as e përligjur, dhe se brenda rumanishtes vetëm fjala aromune ka kuptimin e krun-

des, prandaj pas gjithë gjasësh kjo ka ardhur prej shqipes, e jo anasjelltas.

Për etimologjinë e fjalës do hetuar se ndër format e ndryshme të saj cila është më e para. Ndrimi i grupit *kr* në *gr* në ballë të fjalës është i shpeshtë, gati i rregullt në shqipen, jo i anasjelltë. Prandaj forma bazë është *krunde*, si e vuri re edhe Treimeri e Giuglea, e në kohët e fundit dhe La Piana, Studi ling. alb. Varia 94v. Himet janë ato që shqiten, që ndahen prej miellit në të situ. Kështu pra *krunde* del e afër me gr. *κρίνω* «veçoj, dalloj, gjykoj, zgjedh» *κρίτος* «i veçuar», lat. *cerno crevi* «shoshit, dalloj, veçoj» *cribrum* «shoshë, sitë», irl. e vj. *criathar* «sitë», gjerm. *Reiter* «sitë e komtë», lit. *krijas* «rrethi i sitës» etj. Shkalla vokalelike *-un-* e *krunde-s*, si e pa Jokli, ka dalë prej nazalit sonant. Pra baza e fjalës afërsisht një *\*kr* *-tā* ose një *\*kr* *-ā*. Në rasën e parë do të kishim një particip më *-to*, «e veçuar», e asimilimin *nt : nd*; në të dytën zhvillimin e një *d*-je si tingull homorganik pas *-n*-së. Etimologjia e Treimerit nuk shkon nga ana fonetike. Përveç asaj fjala shqipe që i përgjigjet sllav. *krupa* është *krypë kripë*.

**krusmë** f., në shprehjen *i vuri krusmën* «e mundoi, e torturoi». Fjalë e toskërishtes, që s'e ka G. Meyeri. E jep Godini për «torturë», bashkë me *krusmār* m. «vegël torture». E ka dhe Fjal. i gju. shqipe. Manni (prej Illyrisë) *krruzëm kruzëm* «éradication, destruction», me geminacion ekspressiv të *r*-së e me sonorizim të *s*-së para *m*-së, si te *çizme, dazmë*. Gjithsesi fjalë e toskërishtes. Nga gr. e r. *κρούσμα* «goditje».

**kryenéc**, fem. *kryeneçe* «kokëfortë, i pabindur». Mungon te G. Meyeri, e ka sëpari Junggu si *kryenneç* «testardo», Bashkimi si *kryeneç* «testardo, ostinato, di testa dura». Është një kompozit *krye-neiç* «neje-neje» (si në *dru nejçe*), adjektiv me *-ç* (= *-sh*) prej *neje*, plurali i *nye-s*. Pra *kryeneç* si të thuash «kokëgdhe». Ndihet dhe abstrakti *kryenëci* f.

**krypësht** m. «Alyssum». Këtë emër bime e dëshmon Markgrafi për Mat të epër. Weigandi (Balkan-Archiv II 222) e lidh me fjalën *krypë*, për punë të leskrave të vogla e të bardha që e mbulojnë. «që duken si kokrra krype». Faktori emërtues janë qimet me të cilat është veshur kjo bimë. Prandaj *krypësht* lidhet me *krifshë kripç* etj. «Phillyrea media» e me emrat e disa barërave përmendur atje, me *grifshë krifshë* «Garrulus glandarius» e me *kriph* «gangrenë, qime», e në analizë të fundit me *krip* «flokë, leshra». Kështu *krypësht* përfaqëson një *kripësht*. Velarizimi i *i*-së në *y* është i shpeshtë nëpër dialektet e shqipes, sidomos pranë një labiali; khs. *krymb, lëbyrem, i zymtë* etj.

**kthill** *kthjell* «qëroj qiellin, hap motin»; *kthillet* «po hapet moti», edhe figurshëm «i çelet fytyra»; *kthilloj* «kthill» *kthillohet* «kthillet»; *kthjelloj* «kthill, kthilloj»; *kthjellohet* «kthillet, kthillohet»; *i kthjellët, i kthillët* «i qëruar» (për qiell e për ujë); geg. edhe *këfillt kfillt*. Në Siqeli *fjeyonem* «kthillem» *fjeyë* «kthillët». G. Meyeri 184 e lë të paspieguar, kurse Kamarda (I 101) kishte vënë re formimin e fjalës me prefiks *kë-*. Bugge (Bezenbergers Beiträge XVIII 191) kërkon aty një bashkim të lat. *convertet* «të kthejë» me shq. *diell*, pra një lidhje *\*convertet diellan* që dha sipas tij *\*këthdiell* e *kthjell*. Jokli (Studien 37v.), duke u nisur nga *fjeyë* *fjeyonem* e arbërishtes, e zbërthen edhe ky fjalën në *kë-thiell*, po duke e afuar me *thjeshtë*, e merr si *thie-ll*, me sufiks *-l-*; rrënjorin *the-* të kësaj forme e krahason me sllav. *sinoti* «me ndritë, me shkëlqje» e me got. *skeinan*, ind. e vj. *chāyā* «shkëlqim». Vihet në dyshim te Walde-Pokorny II 536, e nuk përmendet te Pokorny I 917. Sh.

dhe Tagliavini 300 (në Borgo Erizzo *thkjell*, me metatezë). Shp. Bardhi (HD XI 254) e bashkon *kthjell kthill kfill* me *fill*, duke menduar një zhvillim kuptimi nga «mbledh fijet» në «qëroj, vë për fije» etj.

Fjalë e mbarë gjuhës, edhe me formën *kthill*, me *-i-*. Buzuku (XXXII, Isaia 45, 8) *kthielli*, *ju qiell*, *përsipëri*, e *rëtë kthjellnjënë gjyqitë* «Rorate caeli desuper, et nubes pluant iustum», Budi (DC 8, 75, RR 245, SC 302) të *kthjellëtë e të dëlirë; e të vranëtisë e të kthellëtisë; të kthjellëtë; me ata fortëkthjellëtë*. Bardhi Clara dies *Dita e këthjellëtë*, Innubilus *Këthjellëtë*, Perspicuus *Kulluem, o nkëthjellëtë*, Praeclarus *Fort i kthjellëtë*, Radiatio *Të këthjellëtisë e rezevet*, Serenare *Me nkëthjellunë*, Serenat caelum *Qielletë nkëthjellënë*, Serenus *Nkëthjellëtë*, Sudum *Vend i këthjellëtë ndër rët*. Në Pogradec edhe abstrakti *kthilltirë* f. për të kthjelltit e ujit. — Etimologjia e Bugges nuk diskutohet. Spiegimi i Joklit nuk mund të mbahet, sepse, përveç së tjerash, në grupin e sllav. *sinoti* got. *skeinan* ind. e vjet. *châyā* etj. hyn një tjetër fjalë e shqipes, *hie*, që shihet se s'ka lidhje me *kthill*. I vetmi i drejtë mbetet afrimi me *fill*. Ky emër përdoret me kuptime të afra: *e vë për fije, me ardhë në fije; ftilloj* «sqaroj, shkoqit një punë; rregulloj (punët e shtëpisë)», *ftillzoj* «shkoqit, spiegoj», të dyja me metatezë nga *ftill*; khs. edhe *e bëri odën për* «e ndreqi, e nasqirisi, e bëri dritë». Prandaj nga trajtat *kthill* e *fill* kjo e fundit është primarja. E dëshmon, përveç G. Meyerit, edhe Kujunxhiçi për Gjakovë (f. 4, 7): *bistar kfillt*, *bistrō kvillum*, *bistrina kvilla*, *vedro kvillt*, *Pisko* (te Manni) *kfilloj* «spiegoj, sqaroj», që i përgjigjet kryekrejt formës *ftilloj ftillzoj* nga *ftill-* që u zë ngoje më sipër. Edhe në arbërishten arkaike të Sigelisë fjala nis me *f-*. Kuptimi i fjalës te Buzuku «vesë», është sekundar. Një të tillë ndryshim kuptimi ka pësuar dhe lat. *serenus* në greq. e re e në sardishten, sh. G. Meyer Ngri. Studien III 59, Meyer-Lübke REW 7843.

*kuar kuer* m. «masë; radhë; kohë e lirë, e volitshme, nge, rast». Përdoret sot zakonisht si substantiv me funksion adverbial, me prepozicionet *me* e *pa*, shpeshherë shkrirë me emrin në një të vetme fjalë, me kuptimet «me masë; me radhë», «pa masë». Toskërisht del sëpari te Leake 333: *μέτρια* moderately *me kuar*. Për gegërishten dëshmohet shumë më parë: Buzuku (LXXXVII = LXXXVII, Galatët 1, 13, LXXXVI/2 = CVI/2. Timoteut II 4,5; XVIII/2 a; LXXXIV/2 = CIV/2. Proverbet 15, 4) *përse u pā kuor* (ose *pākuor*) *bdonjë klishënë e Tinëzot* «quoniam supra modum persequar ecclesiam Dei», si mbiemër e mbiemër i substantivuar *E ban të je sh përkuor* (shtesë e Buzukut); *E n mordjet së shpjertë e së pākorë, largona neve* «A subitanea et improvisa morte, libera»: *N shpirtit së pākorë e t përkatënuomi, largona neve* «A spiritu fornicationis, libera nos»; *e pākorā uvret shpirtinë* «quae autem immoderata est, conteret spiritum»; Budi (CD 117,187b,SC 132 e shpeshherë) *e të ngranëtë, e të pinëtë tepërë e të pākorë; Ani Evësë i erdhi kori; o aqë ngranë e pī m mbramanet pākuor o aq ncë ngrani encë pimi cë pākorë*; Bardhi Abstinencia *Të përkuerm*, Immoderatus *I pāpërkuerm*, Intemperans, smoderato *I papërkuershim*, Intemperantia *Të pātëpërkuermisë*, Medianus, mezzano *I përkuerm*, Superbibare *Me pī m pā kuer shumë*, Taciturnus *Heshtës, i përkuerm*, Temperans *I përkuerm*, Temperanter *Me të përkuerm*, Temperantia *Të përkuemit*. f. 207 *gūthë kafshërë me të përkuerm*, «Omnia cum mediocritate»; Bogdani (I 3, 9; 8, 4; 48, 5; II 30, 13; 36, 15; 39, 7; 42, 16; 48, 5; 68, 18; 121, 11) *pakuor* «sovente», *tue u gëzuem pakuor* «del che ne riceva una irregolare dilettazone»; *anshtë e naltë*,

ma jo pakuer «è alto, ma non eccessivamente»; me kallëzuem pakuer «abbondantemente a palesare», kujdesi i pakorë «la moltitudine delle passioni»; tue mos hi m ndër vesht aqa fort për këto të lame të pakora «poco curandosi di queste superflue lotioni»; Trajtimi i përkorisë anshtë njënimë «Temperantiae opifex»; Prandaj të përkorëtë, e të dëlirëtë janë gëzueshim «Però, li sobrij, e continenti sono allegri»; Përse kur epetë ujë njëj peme përkuer «Perchè quando s'adacqua un'arbore con medio-crezza»; possi një lym i përkuershim «come un mezzano fiume», khs. sot geg. i përkort(ë) «mesatar, as i madh as i vogël» (A. Xhuvani). Vetëm te Budi del dhe emri në vete, si kuor e kūr: se ajo ende munë presë, e kã lūr; pret mã tjetër kuor me kunguom; e ndë goditë kori qi ta mbërimjë; E mbatëherë kūr godit kori; m u bã kori qi disa e dërgova, disa mbet këtu (RR 126, 76, 276, DC2). me kuptimet «rend, zakon», e «masë»: disa qi janë dalë Sinëzot, e kori cë nierëzet; as e madhe as e vogëlë, po ndë kuort sã desh ligja. Kristoforidhi (f. 172, 350) jep për Shqipëri të mesme me kurë, me kùrazë «me rend, me radhë, me nobet». Aty do të hyjë edhe u prish fëmija kurës «ka dalë fëmija rregullit» në Elbasan; në Sulovë kur m. «fjalë që lidhin dy veta për t'i punuar një punë të keqe një të treti; rresht tre gurësh në lodrën e nëndshit» (Q. Haxhihasani, Bul. për Shk. Shoq. 3, 1955. f. 180). Në Brrar të Tiranës me korez «me radhë». Për geg. veriore Gazulli jep kur-i m. «shtërngesë, masë në haë e pije, periz: sobrietas, abstinentia, Enthalttsamkeit», me hangër me kuri; me i prishë të hollat me kuri; ai nieri s'ka kuri. Junggu i përkuerm «parco, sobrio», i përkuershëm «temperante», t përkuerm «sobrietà, temperanza», Bashkimi i pakorë «insaziabile» t' pakorë «insaziabilità». Ky abstrakt, pakorë f. «të mospasurit masë e qokë në të ngrënë e në të pirë» (Fjal. i gju. shqipe), është substantivimi i mbiemrit i pakorë, opoziti i përkorë, emri përkorë f. «masë në të ngrënë e në të pirë». — Duke njohur vetëm përkuor përkor, të përkuerm «abstinentia» te Bardhi, G. Meyeri 333 mendoj për një verb \*përkonj e për këtë një burim nga lat. parcere «me kursye». Shp. Bardhi (Hylli i Dritës XI 461v.) për gjithë këtë familje fjalësh gurën e gjen te gr. e vj. κόρος «të qenët nginjur». Në të vërtetë kuar kuer, kori, pã kuer pã kori, pakore f., i përkorë, përkorë f. me gjithë variantet e tjera përbëjnë një fjalë vendi, e afër me verbin korr kor, duke u bashkuar me të në një kuptim më të hapët «pres preva». Domethënia e masës e e qokës në të ngrënë e në të pirë rrjedh shpeshherë nga të prerët. khs. preva rakinë, preva duhanin, frgj. couper le vin (te Ernout-Meillet 1023). Po edhe kuptimi i kohës që ka kuar kuer kori, ka dalë nga «pres». Për këtë khs. gjerm. Zeitabschnitt «periodë, epokë» («e preme kohë»), lat. tempus: gr. τέμνω «pres, çaj» (Kretschmer Einl. in die Gesch. d. gri. Sprache 411, KZ 36, 264vv.), angl. time «kohë», në thelb nga «ndaj, pres» (Walde-Pokorny I 764). mbase edhe gr. καιρός çast i volitshëm, kohë,» me κείρω «qeth, pres» (Hofman GEW 128); të tjera shembëlla të J. Charpentier IF 28, 154. Kështu kuar kuer lidhet me i përkorë, i pãkorë, poashtu si tempus e temperare temperans përbrenda latinishtes. Fjalët e shqipes janë një dëshmi e re për këtë që fjalët latine janë të afra në mes të tyre. Përbrenda shqipes kuar kuer rrjedh nga një kor i diftonguar. Të tilla forma paraqet edhe verbi; khs. te Buzuku (LXXXVIII/2 = LXXXXVIII/2, Korintasit II 9, 6) kush rall mbiell, rall kuorën «qui parce seminat parce et metet», në Siqeli (Fjala e t'in Zoti I Nr. 32, f. 3) ai çë mbieh me kursim, kã të kuarënjë edhe me kursim.

**kubël** f. «*Alosa fallax nilotica*». Një formë *kullp kullbi* «një peshk i ujravet t'ëmblla», që jep Hahni për gegërishten, Miklosichi EW 154 e afron me sllav. *kъlb-* që ruhet në rus. *kolba* ukr. *kolbel* pol. *kielb* «*Cyprinus gobio*». G. Meyeri 212 duket se sheh aty një huazim të shqipes prej sllavishtes, sh. dhe Berneker I 659. Për një burim sllav të fjalës shqipe janë Vasmeri REW I 596 e Skoku Jugoslov. Enciklopedija I 163. Ostiri (Arhiv za arb. starinu I 92) sheh këtu dy fjalë afëri në mes të tyre. Selisçevi nuk e shënon ndër huazimet sllave të shqipes.

Fjalë e geg. veriore. Kristoforidhi ka *kulbé*, junggu *kubel kubul*, Bashkimi *kuoël* e *kulbë*; gjithashtu Cordignano, ku jepet edhe kuptimi i saktë; dëshmohet edhe trajta *kujbë*. Si e kemi shtjelluar dhe gjetkë (Bul. i Univ. Shet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. 2, 1958, f. 62, Revue de Linguistique VII 1 f. 172), ky emër peshku rrjedh nga lat. *clupea* «*alosa*» në një formë metateze *\*culpea*. Kjo dha sëpari *kulpë*, me sonorizimin e ditur të konsonantit të silabës fundore në geg. veriake *kulbë*, këndeje më një anë *kujbë*, më anë tjetër me metatezë *kubël*. Kështu kjo fjalë afrohet me span. *kobla*, galic. *jouba*, serbokr. (prej dalmatishtes) *kobla* që janë të gjitha emra të kublës. Ndërkaq mund të nisemi dhe nga një bazë *\*cuplea* e latinishtes provinciale, me të cilën spiegehoh span. *kobla*, serbokr. *kobla* e shq. *kubël*.

**kulte** f. «kungull ujës, susak; fundi i tamrrës». E paregjistruar; përdoret në Shin Gjergj të Tiranës. Nga një bazë latine *\*cuculbita* për *cucurbita* «kungull». Apo nga *\*kurte* prej *cucurbita*, me ndrim *r:l* për brenda shqipes? Sido që të jetë, kemi të bëjmë pas gjasë me një latinizëm të shqipes të *παυρόβραχος*. Lat. *cucurbita* rron dhe në gjuhët romane, ndër to dhe në rumanishten, Meyer-Lübke REW 2365.

**kullana** fpl. «dita e fundit e vitit, nata e motmotit të ri». Me këtë formë e kuptim e përdor fjalën elementi katolik i Shqipërisë veriake, sidomos Shkodra me rrethe, kurse muhamedanët e atij qyteti e kanë për «bora e parë». Junggu *kollan-a*, Bashkimi *kollanë* «strenna, peshqesh i vitit të ri». Në Malsi të Madhe pas Gazullit *këllanët këllanat* «dita e mbrame e motmotit», me *lutë këllanat*. Në Shkodër edhe kënga e rastit që nis me vargun *Mirë dita për kudhana* (me *ll* ndruar në *dh*), kënduar prej kalamajve që shkojnë atë mbrëmje derë më derë. Këtë këngë e ka Prendushi, Kângë pop. gëgnishte 153.

Etimologjikisht *kullana* nuk është për të vënë në një radhë me *kolendra* (G. Meyeri 196), e cila ka hyrë në shqipen prej sllav. *koleda*, kjo vetë prej lat. *calendae*. Te *këllana kullana* kemi një huazim të drejtpërdrejtë nga latinishtja. Veçse nuk vjen nga *calendae*, po bashkë me gr. e re *καλάνδαι*, me format e retoromanishtes (engad. *chalanda k lond*) etj. e të keltishtes (irl. *kalaind* kymr. *calan* bret. *kalanna* etj.) nga *calandae*, e cila çfaqet në latinishten pranë *calendae-s* që në kohë të Augustit, sh. vrejitet tona në Revue de Linguistique VII 1 174. Për trajtat retoromane e kelte khs. Merlo I nomi romanzi delle stagioni e dei mesi 183, Pedersen Kelt. Gram. I 199, 225, Meyer-Lübke REW 1508; për raportin historik që ekziston midis *calendae* e *calandae* në latinishten Walde-Hofmann I 136v., Ernout-Meillet 136. Lat. *calandae* dha në shqipen *\*këllandë*; ajo, me asimilimin e grupit *nd* në gegërishten, dha *këllanë*, e kjo *kullanë*, pl. *kullana*, me ndrimin *a:ëu* në pozicion përpara theksit, khs. *zambak zëmbak zumbak*. Përbrenda shqipes *kullana* qëndron ndaj *kolendra*-vet, ashtu si *καλάνδαι* ndaj *κόλιαντα* «kërshëndella» në greq. e re; format me *-o-*: shq. *kolendra* gr. *κόλιαντα*

bashkë me rum. *colinde*, rrjedhin prej sllavishtes, në radhë të parë prej bullgarishtes. Për greqishten sh. sidomos G. Meyer Ngri. Studien II 32v., III 23, IF 2,80, Triandaphyllidis 120. Për rumanishten khs. *carindar* pranë *colinde*, te Rosetti Mélanges 330.

**kumahárk**, *kumihárk* m. «Libellula, pilivoesë». Mungon te G. Meyeri, e ka sëpari Fjal. i gju. shqipe me të dy format; përdoret në Elbasan e në anët e Myzeqesë. Sikundër e kemi shënuar shkurt te Xhuvani-Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe 63, është e zërthyeshme në *kuma-har-k kumi-har-k*. Aty pjesa rrënjore *har* është' e njëjtë me *harje harije* «Phlebotomus papatasi, insekt i vogël fluturues, që të thith gjakun kur të piskon», geg. *harlë harrël* (sh. *harje*). Elementi *kuma-* *kumi-* është një prefiks i përngjitur nga *kë-më-*, që në pozicion përpara theksit pësuar ndryshimet e ditura të ë-së në *u, a, i*. Një prefiks *ku-* Xhuvani-Çabej (Bul. për Shk. Shoq. 4, 1956, f. 78) gjejnë te *kufirmë* «Symphytum officinale» (sh. *fier*). -*k* te *-hark* është sufiksi i ditur. Nga morfologjia e fjalës del si kuptim i saj «i përgjashëm me harjen».

**kumbull** f. G. Meyeri 213 përmend mendimin e Schuchardtit, i cili gjeante këtu lat. *columba* «pëllumb», pra një deminutiv të saj \**columbula*, po shton se mund të mendohet dhe për gr. *κοκκύμηλον* «kumbull», në Ofis *κοκύπελον*. Në Ngri. Studien III 82 ai gr. e re *κοῦμα* pl. «kumbulla» në Epir me të drejtë e spiegon me fjalën shqipe; gabim Philintas, i cili *κοῦμουλο* e çon te gr. e vj. *κοκκύμηλον*, pranuar dhe te Andriotis 111. — La Piana (Intorno al riflesso della vocale «o lunga» etj. 49v.) sheh këtu një fjalë thjesht shqipe, dalë prej një baze \**kokkúmola* «mollë e kuqe» dhe te gr. e vj. *κοκκύμηλον* një fjalë jo-greke, që greqishtja e ka marrë nga shqipja e vjetër dhe greqizuar nga forma. Edhe Manni (Language 28, 31) gjen këtu një fjalë vendi të shqipes, e afër me irl. *comhaille* «barkosh», irl. e mesme *air-chomal* «fetter on the forefeet» etj. Tagliavini 163 i mbahet mendimit të Schuchardtit.

Fjalë e mbarë gjuhës, te Bardhi Prunus *Kumbullë*. Në Kosovë shënon vetëm kumbullën e kuqe. Duke e shikuar çështjen e burimit gjuhësor në pamjea e historisë kulturore, në lidhje me ndikimin e madh të greq. së vjetër mbi shqipen në fushën e bimëve të kulturës e të pemëve, nuk mbetet dyshim se *kumbull* është gr. e vj. *κοκκύμηλον* me trajtën dorike (veriperëndimore) *kokkúnālon*; sh. Congr. Intern. di Scienze Onomastiche Firenze. — Pisa 1961 f. 250, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4 (1962) 132, 147. Nuk mund të thuhet me La Piana që \**kokkúmola* \**kukkúmbola* *kumbulla* të jetë një kompozit me karakter thjesht shqip, sepse në historinë e shqipes mbiemri paraqitet, me pak përjashtime, rregullisht pas emrit përkatës, sh. Studii si Cerc. lingvistiche X 4 (1958) 544. — Tingulli -b- u zhvillua si tingull homorganik pas m-së brenda shqipes, pa ndihmën e gr. *κοκύπελον* që afronte G. Meyeri. Në këtë mënyrë geg. e sotme *kumëll* me *m* të thjeshtë është një formë regresive. — Për vazhdimet e gr. *κοκκύμηλον* në greçitetin e sotmë të Italisë jugore sh. Rohlf's EW 1049.

**kumt** m. «lajm», *kumtar* m. «lajmëtar, lajmës», *kumtoj* «lajmoj». Mungon te G. Meyeri, po dëshmohet mirë me burimet letrare e dialektore. Bogdani (I 102, 23) ka *shp kumëtitë* «portò la nova». Këtë *kumët* Bashkimi e jep si *kumet*, në grafinë e tij *kumët*, të cilën Leotti me Mannin gabimisht e transkribojnë *kumët*. Gazulli (f. 224, 492) sjell prej Malisë së Madhe *kumt* «lajm çfaret do», të ndiesha *kumtin* «të ndiesha laj-

'min e dekës, të marrtë mordja», e *muer kumtin* «e muer hakun», me *ja hupë kuj kumtin* «me i tretë (bojën), farën, memoriam alicuius dissipare», *mos ma lën me më hupë kumti!*, me *kumtue* «me lajmue, me bā me dij-të». Është një huazim, i pavenëre gjer tani, i lat. *computus* «llogari», duke shkuar kështu me it. *conto* frgj. prov. *compte span. cuento* etj. që kanë po këtë kuptim; sh. *Revue de Linguistique* VII 1 195. Kuptimi i parë i fjalës shqipe ruhet në Kurbî, për të cilin Cordignano pranë *me kumtue* «me dhanë një lajm të zi; me informue, me lajmue» e *kumtar* «lajmëtar i një kumti të zi» dëshmon dhe *kumt* «conto, llogari»; në këtë drejtim na duket se dëshmon dhe e *muer kumtin* «e muer hakun» e Gazullit. Verbi *kumtoj* ndërkaq, më fort se vazhdimi i lat. *computare*, është një denominativ i *kumt*-it, formuar përbrenda shqipes, po me një domethënie si e ka span. *contar* «me numëru» e me «kallzue, me tregue». Mendimi i G. Meyerit (f. 215) që prej lat. *computare* të ketë dalë një tjetër fjalë e shqipes, *kuptoj*, nuk është i drejtë (sh. këtë fjalë). Me këtë bie dhe mendimi i Puscariut (EW 444), i cili edhe ky pas hullisë së G. Meyerit afron *kuptoj* me rum. *a se cumpata* «me u përmbajtë» *cumpat* «qëndrim i matur, gjykim», po këto bashkë me sard. (logudor.) *kumpidare* «me kërkue» e it. *compito* «detyrë: të qenët i matur» me anë të një vargu silogjizmesh aspak bindëse i shpie te lat. *compitum* «udhëkryq», me pëlqim dhe të Meyer-Lübkes REW 2099 e të Ernout-Meilletsë 763. Rum. *cumpat* do bashkuar me *kumët kumt-in* e shqipes, e të dyja hyjnë në grupin e refleksive të lat. *computus*, duke dëshmuar kështu për ekzistencën e kësaj dhe në latinishten ballkanike. Kuptimet e qëndrimit të matur e të përmbaitur që ka fjala rumune spjegohen shumë më mirë nga ai i llogarisë sesa nga nda kryq. khs. shprehje të tilla si *mati fjalët. peshoje mirë atë punë*, gjerm. *berechnend*. Gëthashtu it. *compito* «të cilën edhe atë Puscariu e çon te lat. *compitum* «udhë kryq», nuk është veçse një trajtë e *computo* «llogaritje», e kjo në analizë të fundit identike me *conto* «llogari» që vjen nga lat. *computus*.- Fonetikisht *kumt* me *u*-në e saj prej lat. *o* para dy konsonanteve do gjykuar ashtu si *kurt*, *shpuzë*, *urdhër*, të cilat dhe në rumanishten janë me *u*, sh. për këto Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1045. Fjalët përkatëse të greq. së re që janë me *-o*- nuk lejojnë të mendohet për ekzistencën e *u*-së që në latinishten ballkanike (Siadbei). Kjo *u* e rumanishtes dhe e elementit latin të shqipes duhet t'i përkasë një procesi të mëvonë të këtyre dy gjuhëve, sh. vrejtitet tona në *Revue de Linguistique* VII 1 198. — Në gjuhën moderne të shkrimit *kumtoj*, me neologjizmin *kumtim*, duke u nisur përdoruesit e saj nga ndjenja e padrejtë se rrjedhka prej lat. *communicare* it. *comunicare*, ka hyrë më fort me domethënien e kësaj fjale. Lat. *communicare* ka dhënë *kungoj*.

**kumtër, kumptër, kundër** m. «kumbarë». Shikohet përgjithësisht si një huazim nga lat. *compter*; khs. G. Meyer 214, Meyer-Lübke (Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1045, Mitt. d. Rum. Inst. Wien I 4, REW 2096), Wogand 41, Berneker I 662, Bartoli Jagic-Festschrift 55, Vasmer REW I 578. Skoku (*Revue des Et. Slaves* X 187 shën. 2, 189 shën. 3) me të drejtë vë re se shq. *krushk* rum. *cuscru* e shq. *kumtër* rum. e vj. *cumatru* vijnë prej bazash latine proparoksite *cónsocer cômpter*, në kundërshtim me format e latinitetit perëndimor; e me të drejtë ai vë në pah burimin latin të fjalës rumune, jo sllav si mendonin disa dijetarë, si G. Meyer, Ber-

nekeri, Meyer-Lübke. Me Skokun bashkohet Rosetti, *Mélanges* 315.

Në shqipen është fjalë e mbarë gjuhës, edhe e arbërishtes së Kalabrisë e të Siqelisë (*kuntri* «il compare», Kamarda II 151). Forma e sotme *kumtër* rrjedh nga *kumëtrë*, e cila u ka ruajtur gjer në momentet e para gjuhësore: Buzuku (XXV/2a, me nderimin e shpeshtë të *u*-së në *o*) *E aty prifti vete tek pagëzonetë me gjithë djalë, e aty pyetën kumëtritë si e kluonjënë atë djalë*. Budi (p.sh. RR 14, 16, SC 2, 342, 393, 396) e të shënonjë gjithë sã foshnje të pagëzonjë, e ditënë, e vjetëtë, e emënatë e tyne, të prindet, e të kumëtrët; e me kumëtrë, e me ndrikullë; o kumëtriet e vëllazënit; as gjenë e kumëtri. Që fjala ka qenë përdorur dhe për kumbarinë e martesës, këtë e vërteton forma e Dibrës *kumtri* f. «rrobet që i çon dhëndri nuses për martesë» (Vis. e Kombit IV 112), ku abstrakti është zhvilluar në një emër konkret. Shq. *kumëtrë*, me ruajtje të -ë-së në trup fjale dalë nga *a*-ja e pathekse latine (sh. dhe Bul. për Shk. Shoq. 1, 1956, f. 125 shën. 7), piqet më së miri me rum. e vj. *cumatru* dhe dëshmon edhe nga ana e shqipes karakterin latin të fjalës rumune, sh. *Revue de linguistique* VII 1 170. — Sa për burimin e *kumtër*-it, prania e -p-së te *kumptër* nuk përbën një dëshmi të mjaftueshme për ta çuar fjalën te lat. *compater*; zhvillimi fonetik i një okluzivi labial pas *m*-së është i shpeshtë në shqipen. Fjala shqipe nuk mund të ndahet nga ajo e rumanishtes. E sikundër që këtë bashkë me sllav. e vj. *къmotra* «ἀνάδοχος» e spiegojnë nga lat. *commater*, edhe *kumtër* mund të ketë dalë prej kësaj fjale latine e të jetë bërë mashkullore si fjalët rumune e sllave.

**kund** «gjëkund, më ndonjë vend»: *a e pe kund?*; «asgjëkund»: *nuk shifet kund*; «afro. nja»: *kund gjashtë metra e gjatë*; «eventualisht». S'e gjejmë te G. Meyeri. Weigandi 41 e jep me varianten *kundi* që ndihet pranë *kund*, dhe sheh aty refleksin e lat. *unde* «nga, prej nga». Jokli (Arhiv za arb. starinu I 35v.), duke u mbështetur dhe në të dhëna si *kund kafshë e mirë* «aliquid boni», te Bogdani, gjen këtu një kompozit me kuptimin «çë», përbërë nga përemri pyetës *kë* (neutër) e nga *-d -t*, mbeturinë e dëftorit indoeur. *to-*. Përbrenda shqipes *kund* sipas tij është e afër me *kë* e me *kë-nd kënt*, e *-u*-ja te *kund* u zhvillua prej -ë-së së *kënd*-it në pozicion të patheksuar.

Me gjithë se në përdorimin vetëm, si *kund*, *kundi*, rron vetëm në gërrishten, nga kompozitet e saj shihet se kjo është fjalë e mbarë gjuhës. Këto janë ndajfoljet përemërore *gjëkund gjëkundi* e *asgjëkund* me variantet e tyre, e si *moskund* «si në asnjë vend tjetër» në Himarë, kjo e krahasueshme me si *moskush* «si kurrkush tjetër» poaty, e me si *moskurrë* «si kurrëndonjëherë më parë», në Gjirokastër. Vetëm gegërishtes i përkasin sot *gjithkund gjithkundi*, *askund askundi*, *kurrkund kurrkundi* e *tjetërkund*. Si e kemi shënuar shkurt dhe te Bul. i Shk. Shoq. 4 (1953) 36v., *kënd* është *kë*, *kund* është *ku*, *send* është *se* etj., të gjitha me *d* fundore sekundare, zhvilluar me rrugë thjesht fonetike. Kjo shihet si nga kuptimi i këtyre fjalëve si dhe nga trajta që kanë këto në disa dialekte periferike: në Greqi (G. Meyer, Alb. Studien V 79) *gjękú* «gjëkundi, diku»,

në Borgo Erizzo pranë *gikush* «gjithkush» *gjkú* «gjithkund» (te Tagliavini 130). Lidhjen e *gjëkund(d)* me *ku* e vuri re sëpari Kamarda I 307. Mënyrën e formimit të *gjithkund* Sandfeldi 79 e krahason me të drejtë me atë të serbokr. *svagdje*, edhe kjo *sva-gdje* «gjithë-kund»; khs. dhe it. *per ogni dove* «gjithkund, gjithandej», angl. *everywhere* «gjithkund», e për

formën dhe gjerm. *allwo*. Edhe kuptimet kryesore që ka *kund* bashkë me kompozitet e saj, si *gjëkund asgjëkund*, (*si moskund, gjithkund, askund, kurrkund, tjetërkund*, tregojnë se kjo ka kuptim vendi. Të tjerat përdorime janë sekundare; për atë të «nja, afro, eventualisht» *kund* krahasohet me gjerm. *etwa* «afro, afërsisht; mbase, gand», që etimologjikisht lidhet me *wo* «ku», sh. Kluge-Goetze 140. Kalimi i kuptimit lokal në modalin është' i shpeshtë, ai vihet re dhe te kompoziti i *kund-it* *gjëkund gjëkund*, në shprehje *s'ngjajnë gjëkund* «s'përngjajnë aspak». Sa për formën e fjalës, mendimin që *-d*-ja te *kënd, send, kund* e në të tjera fjalë të këtij lloji është një shtesë relativisht e re, e vërtetohet puna që këto fjalë te Buzuku e pjesërisht dhe te Bogdani çfaqen pa *-d*. Kështu *kund* Buzuku e ka rregullisht herë *kun*, herë *kon*, e në kompozicion *-kun*: *përse mos jetë grishunë kun një mǎ i madh se je ti* «ne forte honoriator te sit invitatus»; *Askush nukë ban kun gjākafshë r,de e r,fshehunë* «Nemo quippe in occulto aliquid facit»; *M̄bēlidhni copētē qi r,βetnē, përse mos eē kon gjā poshtē* «Colligite quae superaverunt fragmenta, ne pereant»; *e tue shëndoshunë gjithëkund* «et curantes ubique» (LXXVIII = LXXXVIII, Luka 14,8; LX/2 = LXX/2, Gjoni 7, 4; LX/2, Gjoni 6, 12; LXXI = LXXXI, Luka 9, 6). Te Budi tanimë del *kund*, p.sh. DC 62, RR 30, 45 *kund mbë ndonjë vend të dëlirë*, DC 182 a b *Aqë sǎ kund nieri Kēncō jete si shpētoi, Ndo ke jō tu punuom Kund kafshë mbë këtë jetë*; edhe Bardhi Remanere *Me mbetunë kund mbë ndonja* (gab. shtypi *rdonja*) *vend*. Sot në Gegëri më fort *kund*, p.sh. *Çika e pa kund shoqe* (Kurti I<sup>2</sup> 96), në Dibër *kundi*; po në Shestan *kun kon* si te Buzuku. Në Toskëri *gjëkund gjëkund* *gjakuni gjakundi* etj., po në dialektet e kolonive kudo pa *-d*; Piana del Greci në Siqeli *gjakun*, në Kullur (Salaminë) të Greqisë po *s'pa gjakun gjë* *μά δέν εἶδε πουθενά τίποτα* (Furikis, *Αθηναῖ* 45,86). Edhe këto forma dëshmojnë për karakterin aksesor të *-d*-së.

**kungë** f. «pjesa e kishës që vjen pas altarit kryesor, ansis: vend i mbyllur në kishën ortodokse», te Kristoforidhi *τό ἱερόν βῆμα* G. Meyeri 214 e bashkon me *kungoj kungim kungatë* nga lat. *communicare*, ashtu dhe Berneker I 557.

Është një me *konkë*, te Buzuku: e *vu mbë konkët përsipër të klishësë* «et statuit eum supra pinnaculum templi»; *E hinje se konka e klishësë u dǎ n̄ d̄ pjesësh n̄ majet deri fondi* «Et ecce velum templi scissum est in duas partes. a summo usque deorsum» (XLIII, Mateu 4, 5; LV = LXV, Mateu 27, 51). Kjo *konkë*, për punë të kuptimit që ka, nuk mund të jetë it. *conca* «tas, magje, govatë», po është trajta që i përgjigjet *kungë-s*, me *o*-në e Buzukut për *u*, si te *fond, kломështë, kon, kongonj*. Në Nikaj-Mertur *kungë* i thonë secilit nga ato dy mure trekëndshe nga lart, që veshin shtëpinë-kullën anëve (E. Lafe). *Kungë konkë* është lat. *concha* «gocë deti»; edhe «golle, kube në një pallat», sh. kuptimet te Ernout-Meillet 210v. Për ndrimin e lat. *o* në *u* në shqipen përpara dy konsonanteve khs. Meyer-Lübke, Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1045, sh. edhe *kumt*. Nuk mohohet ndërkaq një ndikim nga ana e fjalës *kungoj kungim kungatë*, me etimologji popullore, sikundër shihet dhe te përcaktimi i *kungë-s* te Fjal. i gju. shqipe «vend i mbyllur në kishën ortodokse, ku bën prifti kungatën». Një gjë e tillë ka ngjarë edhe me *gungë* me kuptim të kungës, te Junggu «gobba, cupola», te Bashkimi «gobba, cupola,

abside di chiesa», duke u përzier *kungë* me *gungë* «bullungë; xhungë e kurrizit».

**kuptoj** «marr vesh, rrok me mend, ma merr mendja»: *kuptim* m.; *i kuptuar* «i mençëm, me mend»; *i kuptueshëm* «i kuptuar»; që kuptohet»; në Itali *kupëtorë* «i kuptuar». G. Meyeri (f. 215, Alb. Studien IV 38) e spiegon, bashkë me rum. *cumprata* «me u përmbajtë», nga lat. (o it.) *computare* «me llogaritë, me numëruë». Meyer-Lübke më parë (Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1048) i mbahej këtij spjegimi, po në REW 2099 — mbi hullinë e Puscariut EW 444 — fjalën e rumanishtes e të shqipes, bashkë me disa të tjera të gjuhëve romane, i shpie te lat. *compitum* «udhëkryq». Weigandi 41 e spiegon *kuptoj* nga it. *capito* «kuptuar», duke hedhur poshtë çdo afrim me rum. *computa*, që largohet krejt nga kuptimi, e me këtë dhe spjegimin nga lat. *computare*. E pranon Jokli Indogerm. Anzeiger 55,35.

Fjala rumune hyn aty ku e pat venduar G. Meyeri, po prej shqipes m'atë vend do shtuar jo *kuptoj*, po *kumt*, sh. Revue de Ling. VII 1 195. Sa për *kuptoj* (më e vjetër dhe popullore *kupëtoj*) kjo s'është gjë tjetër veçse *kaptoj*, një zgjerim faktitiv-intensiv më *-(ë)toj* i verbit *kap*, ashtu si *madhëtoj*, *shtekëtoj*, *zitoj* që trajton Jokli (Mitt. d. Rum. Inst. Wien I 302, LKU 13, Zbornik Belić 42, Revue Intern. d. Et. Balk. II 64, Archiv. Romanicum XXIV 16), e si *argtoj*, *copëtoj*, *dëmtoj*, *fajtoj*, *pretoj* etj. që japim ne në Bul. për Shk. Shoq. I (1956) 134 shën. 1, Revue de Ling. VII 1 194. Dhe me të vërtetë, te Logoreci gjejmë *me kuptue* «me kapë, me rrokë me anën e shisevet vrragat e sendevet të jashtme e nëpër të cillat mbasandej përftohen në mende idët, qi tue i rrahun e kujtue kuptohen, d.m.th. se ma parë i kaptojmë idët e mandej i kuptojmë». Pra *kaptoj* «rrok me mend, kuptoj». Dhe me të vërtetë, në Shqipëri të mesme (Shpat, Elbasan, pas M. Çelikut në Peqin) ndihet *kaptoj* për «kuptoj». Në disa vise të Toskërisë (pas M. Totonit Rëzoma e Delvinës) thonë *këptoj*. Pra shkalla e zhvillimit fonetik është *kaptoj*: *këptoj*: *kuptoj*, me reduktim të *a*-së së pathekse në *ë* e labializim të kësaj në *u* në afërsi të konsonantit labial, labializim i shpeshtë nëpër dialektet e shqipes: *baltë*: *mbëltoj* *Beltojë*: *Bulticë* (sh. *baltë*), *daltë*: *deltinë*: *dultinë*, *zambak*: *zëmbak*: *zumbak*. Për semantikën do shënuar se kuptimi i të marrurit vesh, i të rrokurit me mend del shpeshherë nga konkreti «marr, kap, rrok». Khs. it. *capire* nga lat *capere*, frgj. *comprendre* nga *comprehendere*, *saisir*, lat. *percipere*: *capere*, gr. *καταλαμβάνω*: *λαμβάνω*, gjerm. *begreifen*: *greifen*, got. *ganiman* etj. khs. dhe *marr vesh*, *marr me mend*. Në shqipen e Greqisë rrëmben do të thotë edhe «kuptoj» (G. Meyer 374, Jokl Slavia XIII 316), edhe në Gjirokastër, në Elbasan e gjetkë e rrëmben «e kupton menjëherë», geg. *s'ma rrok mendja* «s'ma merr mendja, s'arrij ta kuptoj». Edhe vetë *kap*, primitivi i *kuptoj*, gegërisht përdoret dhe me domethënie e kësaj, e *kapi* «kuptoi menjëherë», *s'(m)und e kapi*. Ndërkaq nuk është e sigurtë që *kaptoj* *këptoj* *kuptoj* të jetë një me *kaptoj* «kapërcej»; kjo mundet të ketë dalë pikësisht nga *kaptë* (sh. *kaptoj*).

**kurnác** «dorërrudhur». Mungon te G. Meyeri. Prej turq. *kurnaz* «dinak, dhelparak». Mbështetur emrave e mbiemrave pejorativë më *-ac*, për të cilët sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 6v.

**kurt** m. «oborr». Nga lat. vulgare *cōrtem* për *cohortem*, khs. rum.

*curte*, gr. e re *κοῦρτα*. engad. *kuort* it *corte* etj.; G. Meyer 216, Ngrî Studien III 36, Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1045. Është për të vënë re mendimi i Miklosichit, përsëritur prej G. Meyerit, Puscariut (EW 462, Dict. li. rom. 1034v.) e Skokut (Starohrvatska Prosvjeta N.S. 2 = IJ XIV VII 188) që rum. *curte* shq. *kurt* sard. e vj. *curte*, gr. e re *κοῦρτα*, lat. e Dalmacisë mesjetare *Curtis* çojnë te një lat. e vonë *curtis curtem*, e shpeshtë dhe në kanunet gjermanike. Me këtë spjegim del i kotë mendimi i Giugleas (Dacoromania III 472), pranuar dhe te Meyer-Lübke REW 2032, që rum *curte* shq. *kurt* të kenë rrjedhur nga greqishtja. Këtë mendim e hedh poshtë edhe Puscariu.

Sllav. *obor* (b) e gr. *avli avli* e kanë mënjënjat mjaft këtë huazim latin të shqipes dhe i kanë lënë atij një përhapje dialektore. Në punë të fleksionit të saj kjo fjalë edhe në periodën letrare ruan gjininë femërore të bazës latine. Kështu te Buzuku gjejmë ndër të tjera *Pjetri por e ndiq për së largu, djerie tek kurtja e t parit priftënet* «Petrus autem sequebatur eum a longe, usque in atrium principis sacerdotum» (LXIV/2, Mateu 26.58). Si femërore do shikuar fjala atëhere dhe te Budi (DC 204b, SC 316): *Ndë të ci t kurtë shkretë, ndë kurtë njaj zotnje*. Renditja në tokun e mashkullores (*kurt-i*) nuk do menduar me Joklin (IF 36, 138) si një formim i ri nominativi prej akuzativit, po me procesin që është shtjelluar në Li. Posn. VIII 113 vv.: *kurt short shëndët* etj. pas hiferezës së rregullt të -e-së latine, u ndien në periodën e fundit të gjuhës si t'ishin mashkullore dhe hyjtën mënjënjat në këtë klasë emrash. Poashtu ngjau me disa fjalë vendi si *djep end et gjeth*. Prandaj është gabim të deduktojmë nga *kurtja*, që Buzuku ta ketë emrin *kurte*. — Zgjerimi *kurttar* m. «oborrtar» i Bashkimit është një neologjizëm që s'ka zënë vend në gjuhë. Përkundrazi *kurtëroj* «bëj punë shtëpie» e Tasit mund të jetë e gjuhës popullore.

**kurtinë** f. «perde». Këtë fjalë, që s'e ka G. Meyer, e jep sëpari Kristoforidhi (f. 173), duke e nxjerrë nga lat. *cortina* (tek ai gabimisht *curtina*). Në kundërshtim me ç'kemi thënë te Bul. i Shk. Shoq. 2 (1954) 43v., ku gjenim këtu një huazim të shqipes nga italishtja, tani mendojmë se *kurtinë* më fort është vazhdimi i lat. *cortina*. Fjala latine, edhe pse i mungon rumanishtes e dalmatishtes, ka qenë dhe në latinitetin ballkanik, sikundër dëshmon gr. e re *κοῦρτίνα κοῦρτίνα* «perde; çadër, tendë, shator»; sh. për këtë G. Meyer Ngrî. Studien III 36, Triandaphyllidis 120 — Çam. (Margëllëç) *kurtinë* «çatore e kuqe me të cilën marrin nusen» me -n-në e saj duhet të jetë një huazim nga gr. e re *κοῦρτίνα*.

**kurrë** G. Meyer 215 e barazon me *kur*, duke i çuar të dyja te lat. *qua hora*. Sot pranohet gati kudo mendimi i Pedersenit (KZ 36, 317, sh. dhe Kelt. Gram. I 127) që *kurrë* ka dalë nga një \**kur ne(i)*, me një element mohues *ne(i)* si shtesë, i krahasueshëm me frig. *ni* e rus. *ně* «nuk», pra *kurrë* përbrenda shqipes e afër me *kur*, *ku*, *kush* etj.: khs. Jokl Zbornik Belić 55, Walde-Pokorny I 521, Walde-Hofmann I 313 II 739, Ostir Wörter und Sachen V 311 shënim. Tagliavini 164, Pokorny I 647. Më parë (Alb. Texte mit Glossar 145) Pedersenit për *kurrë* përkundërt *kur*-it kish menduar praninë e një elementi që i përgjigjej ind. së vj. *kana* pra \**kurkë*në: \**kurnë*: \**kurnë*: *kurrë*. Sh. edhe Vasmer Studien I 34, Bariç Arhiv za arb. starinu I 214.

Shënimi i Kamardës (I 305 v.) që *kurrë* do dhe pjesëzën mohore

(*nuk*, *s'*) për të shprehur mohimin duke mos pasur fuqi vetiut për këtë punë, përmban një thelb vërtetësie. Veçse do modifikuar në këtë vështërim, që *kurrë* nuk ka pasur më vete ndonjë element mohimi; ky u sajua me përdorimin sintaktik të fjalës. Si në të tjera gjuhë, edhe në shqipen koncepti i «kur«-it e i «kurrë»-s shprehet me një fjalë të vetme; i dyti për nga forma gjuhësore u diferencua nga i pari në ngërthim të fjalisë. Sa afër janë të dy fjalët midis tyre në punë të kuptimit, shihet nga kjo që *kurrë* përveç se «asnjëherë» do të thotë edhe «ndonjëherë», në fjali pyetëse si *e ke parë kurrë?* Prej këso rasash shihet se *kurrë* nuk përmban ndonjë element mohimi sikundër mendohet. Kuptimi mohues leu në fjali mohore, si *s'e kam parë kurrë*, e cila nga «s'e kam parë ndonjëherë» u zhvillua në «s'e kam parë asnjëherë». Kështu adverb i kohës së pacaktuar u bë adverb kohësor mohimi. Kështu edhe frgj. *jamais*=*ja-mais*, nga lat. *iam* + *mais* «më» nga lat. *magis*, pra si me thënë «tashma», përdoret dhe për «ndonjëherë» (*vit-on jamais*..?) dhe (në fjali mohore) për «asnjëherë». Dallimi formal i *kurrë*-s nga *kur* u bë dhe fonetiki dhe për nga morfologjia. Fonetiki me anë të geminacionit ekspresiv të *r*-së, duke dalë kështu *kurrë* gati si një *kur* e përforcuar. Është një mjet diferencimi kryer përbrenda gjuhës, kështu që zhduket nevoja e spjegimit të *rr-së* prej një grupi *rn*. Morfologjiki *kurrë* u diferencua nga *kur* me anë sufiksesh e prefiksesh. Kështu, ndërsa Bardhi ka Numquam *hurrë*, Buzuku përdor *kuraj* e *kurajtë*: *qi kuraj jashtë arëset sit ata të mos kenë me dalë as me fëjyem; qi kurajtë s ashtë klenë qysh së zanët së shekullit djerie tash, as të jetë kurajtë* «qualis non fuit ab initio mundi usque modo, neque fiet» (XXVI/2b, LXXXII/2 = LXXXX/2, Mateu 24,21). Budi me Bogdanin kanë *kurraj*. Diferencimi me anë prefiksesh dha *askurrë*, tosk. jugore *si moskurrë* «si kurrëndonjëherë më parë». Të gjitha këto forma *kurrë*, *kurraj*, *kurrnaj*, *kurajtë*, *askurrë*, rrjedhin nga prirja për një «hiperkarakterizim gjuhësor» në kuptimin e E. Schwyzerit; sh. për këtë dukuri edhe në shqipen Studii si Cerc. lingvistica X 4 (1959) 534 vv. Kompozitet me *kurr* si element i parë, si *kurrfarë*, *kurrgjâ*, *kurrqjasend*, *kurrnjisend*, *kurrkah*, *kurrkund*, *kurrkush*, *kurrnjëni*, *kurrqysh*, *kurrresi* janë formime popullore të gegërishtes; tosk. *kurrgjë* u sajua pas gjedhes së geg. *kurrqjâ*. Te *kurrën* e *kurrës*, *kurrësëkuri* kemi të bëjmë me një «deklination të indeklinabilieve».

**kush**; *kushdo*; *kushedi* «mbase, ndoshta». Për këtë fjalë gjuhësia me të drejtë i është larguar spjegimit — dhënë me rezervë — të G. Meyerit (Gröbers Grundriss I § 57, EW 217 v). prej lat. *quis*, dhe pranon me Pedersenin (KZ 36,317) një burim prej përemrit pyetës indoeur. *kuo*; khs. ndër të tjerë Brugmann II 2 § 345, Walde-Pokorny I 522v., Tagliavini 165, Pokorny I 647. Edhe për *kuj kujt* të gjindore-dhanores që prej Pedersenit e këtej më nuk pranohet një burim nga lat. *cuius* që mendonte G. Meyerit. Pas Pedersenit *kuj* leu duke iu shtuar analogjiki temës *ku*- mbaresa *-i* e gjindores. e *kujt* me shtesë të artikullit postpozitiv *-t*. Burimin e akuzativit *kë* nga indoeur. *kuom* e pat përsjatur dhe G. Meyerit vetë (Alb. Studien III 88). Përkështu dhe Pedersenit, Bernekerit I 675, Vasmerit REW I 676 etj. Zhvillimin përbrenda shqipes (nëpër *kë*) e shtjellon Jokli IF 36,99, Arhiv za arb. starinu I 35 (sh. *kënd*).

Përdorimi për «asnjeri» në fjali mohore, si për *kush* (*s'erdh kush*) si

për kompozitet e saj *askush*, *kurrkush*, është vetëm i gegërishtes, e nuk duket të ketë genë i shqipes së vjetër. Nominativin e zberthejnë në *ku-sh*, ku *-sh* pas Pedersenit duhet të jetë mbeturina e një elementi përemëror të pacaktueshëm më saktë. Nuk është thënë asgjë për kronologjinë e kësaj shtese. Pas mendimit tonë ky spjegim i *kush-it* has në vësh-tirësi të mëdha; një element *-sh*<sup>1</sup> i këtillë nuk ka analogji as vetë në shqipen as në rendin indoeuropian. Në çdo rasë *sh-ja* fundore e sotmja reflekton një *s* në trup fjale, e cila si e tillë nuk pësoi apokopën e rregullt të tingujve fundorë, po u mbrojt nga vokali fundor, i cili me kohë ra. Kështu pra *kush* ka genë dikur dysilabike ashtu si *kur* e si *mos*, Mbase e krahasueshme nga ajo anë me tokar. B *kus-*, *ksa*, *kse*, përemër-pyetës, i pacaktuar e lidhor, për të cilin khs. Meillet IJ I 13. Ose trajta bisilabike u sajua përbrenda shqipes, veçse ajo në çdo rasë duhet të jetë e vjetër.

**kusht** m. «premtim hyjnisë; bast, kaull; konditë, shart»; *kushtoj* «bëj një kusht hyjnisë; fal, dedikoj»; *kushtim* m. «kusht, premtim hyjnisë». G. Meyeri 217 e ndan këtë fjalë nga *kuston* «ka këtë çmim» *kustim* «çmim». Këtë të fundit e spjegon nga it. *constare* (zakonisht *costare*); te *kusht kushtoj* sheh një huazim më të vjetër, prej latinishtes. POKËSHU Puscariu EW 465; e për *kuston* Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I<sup>2</sup> 1049, Helbig 54.

Me përdorimin fetar del që te Buzuku (LXXXIV/2=CIV/2, Libri i Proverbevet 15,8): *Sakrificiatë e bākëqivet janë nde e deshplqyem Tinëzot, e kushtimetë e dërejtëvet nde e plqyem* «Victimae impiorum abominabiles Domino: vota iustorum placabilia». E dhe Budi ka (DC 88, SC 41) *Një të madh të përmetuom, e kushtim vetë adë vetëhe. Të pyetunitë kushtimeshi cë bōme: A mos ishnje kushtuom me gjithë zemërë e vullëndet, me hi m kund ndë ndōnjë munështir*; Bardhi votum *Kushtim*. Në shqipen e Greqisë *gusht* «bast», *vemë gusht?* «vemë bast?», G. Meyer Alb. Studien V 79. Me gjithë këto dëshmi, as në latinishten as në italishten nuk ka bazë për të kërkuar aty kuptimin e parë të fjalës. Emri *kusht* gjan të pasqyrojë it. *costo*: *ad ogni costo* dha me çdo kusht, a *nessun costo* dha me asnjë kusht. Kështu kuptimi «konditë» del si më i vjetri. Prej *kusht* «konditë» u kalua më një anë te *kusht* «votum», më anë tjetër te *kusht* «bast». Kronologjikisht *kusht* duhet të rrjedhë prej italishtes së vjetër, o me *-sh*-në e saj edhe prej venecianishtes. Kundra etimologjisë latine të *kusht-it* flet kjo që lat. *constare* në gjuhët romane paraqitet me kuptimin e shitjes me një çmim të caktuar; për rum. *custa* «me jetue» *kust* «jetë» du thënë se me kuptimin e saj qëndron mjaft e izoluar si përkundrajt gjuhëve romane përendimore si përkundrajt shqipes. Në këto rrethana mundet që *kushton* «ka këtë çmim» të jetë një huazim nga latinishtja, i cili në periodën e ndikimit t'italishtes u poq me *kusht* nga it. *costo* e u përzie me të. Kështu fjala gjan të jetë marrë dy herë nga ana e shqipes. Në këtë mes edhe verbi *kushtoj* «bëj një kusht; fal, dedikoj», denominativi i *kusht-it*, u përzie në formë me *kushton* «ka këtë çmim» nga (lat.) *constare*, duke u shkruirë me të në një fjalë të vetme.- Trajta *kuston koston* bashkë me emrin *kosto* f. janë italianizma të reja, me s të ruajtur e jo të ndruar në *sh* si te *kusht*.

**kushtrim** m. «thirrje nën armë në kohë lufte; thirrje natën për ndihmë kundra kusarëve, alarm». Mungon te G. Meyeri. I gabuar spjegimi i Weigandit (Balkan-Archiv I 257) nga një \**kushtorim*, prej *kusht*

*kushtoj*. Është *kush trim*? Lambertz 101, Die Volksepik der Albaner 247. Fjalë e dalë prej një fjalie, si p.sh. *druese*, *mbase*, *diç*, *shklata*, *takan-da*. Për *kushtrim* khs. sidomos *çështje*, *kushedi* «mbase», e rum, *cimili* «me gjetë me mend» *cimilitura* «gjëzë» nga *ci m il spuñe?* «kush ma thotë?» (Weigand te Meyer-Lübke REW 3054).

**kuvise** fpl. «kuvende, bisedime». Del sëpari te Bogdani (I 95,39): *Fjala gjithëherë ndë kuvise të nierëzet ka zdropunë* «Verbum ad humana semper colloquia descendit ab Adam»; në Dibër *kuvejse*; te Puijevski (Rečnik od tri jezika, 1875, f. 100, 24) *kuvisa* «receni», *me kuvise* «so sborovi»; te N. Veqilharxhi (1845) *fjalë e kuvise të huaja*. Jokli (IJ XI VII 190) e shikon si një postverbal të *kuvinj*, e cila sipas tij vjen prej lat. *convenio* dhe është paralel me *vinj* nga lat. *venio*. Për ne *kuvise* është një formim paralel me *kuvende* nga lat. *conventum*. Kjo në ndjenjën gjuhësore të popullit u muar si *kuvende*, duke u lidhur në këtë mes me *vende*; *-vende* u zëvendësua me *-vise*, e u arrit kështu në *kuvise*. Nga emri u formua verbi *me u kuvisë*. E sikurse *vise* ka dalë nga *vëse*, kështu edhe pranë *kuvise* ka edhe (te Gazulli) *kuvëse-t*, e paralel me këtë edhe verbin me *kuvëse*: Po *kuvësin Marku e Lushi*, në Ishull të Lezhës *ta kuvësim* «ta bisedojmë, ta kshillojmë së bashku»: sh. Li. Pos. VII 149v., VIII 126 v. — Sh. dhe *kuvënesë*.

## R é s u m é

## ETUDES D'ETYMOLOGIE ALBANAISE XII.

**kërcú kërcú** m. «souche (d'arbre)». Plutôt que d'un krc «tronc, tronçon» du slave, le mot provient des sources indigènes. De la forme primitive *kërcun* tire son origine le roum. *craciun* «Noël» en tant que «nuit de la souche», tout comme l'alb. *nata e buzmit* «la veille de Noël» signifie mot à mot «la nuit de la souche».

**kërcëp** m. «rameau transversal, tuyau sec, éclat de bois» est à rapprocher à *kërçabë* «legno che si pone al collo degli animali, come porci, ecc., affinchè non possano passare le siepi dei campi», come un pluriel métaphonique singularisé.

**kërrëndi** f. «décombres, gravats». Du turc *kirinti* «miettes, tessons», qui a subi l'évolution du groupe nt à nd.

**kërmë** f. «charogne». N'a rien à faire avec *kërdis* «massacrer» *kërdis* «carnage, massacre» d'origine turque, ne provient non plus du néo-grec *κορμί κουρμί* «corps», mais du bulg. *кърма* «pâture, man-gaille».

**kërmill** m. «escargot, limace». N'est pas le proche parent du frç. *escargot* esp. *caramujo*, ni apparenté à *ἀσραμούλα* «escargot» du grec de Tarente, ni emprunté au gr.-lat. *ceramida*. C'est le pluriel singularisé de *krimb* «ver» (W. Cimochoowski). De ce même mot proviennent, par la même voie, *kër(r)mí-a* f. «*Anobium pertinax*» et *kërmí* m. De *kërmill* dérivent en outre, par une fausse conception du mot comme *kër-mill*, les formes *kaçamill*, *kakami*, etc., et, par une

substitution de suffixe, kërmeç. A rejeter les rapprochements de M. K. Bouda IF 59,208.

**kërnëtë** gërnëtë f. «clarinette». Non pas de l'it. clarinetto qui a donné tout récemment klarinetë, mais un emprunt populaire de l'it. cornetto «cornet». Plus ancien est garetà «tuba» dans Gj. Buzuku, reflétant un gërnëtë et précisément un \*gërretë, toutes formes à occlusive sonorisée, en position initiale.

**kërqelë** f. «couteau qu'on porte à la ceinture». Plutôt que d'un emprunt au lat. circellus «cerceau» qui a donné partout des mots désignant les pendants d'oreilles, il s'agit d'une forme régionale de kurtjelë «sorte d'épée courte et droite».

**kërshëndella** kërshëndelle fpl. «Noël». Pour des raisons d'ordre phonétique, non de Christi natalia, mais plutôt de Christi natale (H. Pedersen). C'est un pluriel métaphonique, qui suppose un \*kërshëndáll. Le mot albanais est l'unique reflet qui subsiste du lat. Christi natale. Ce nom de fête correspond par sa forme au gr. Χριστούγεννα. L'actuel nom de cette fête, krishtlindje, semble être un calque moderne du mot grec.

**kërshnjët** m. «Phillyrea media». A rapprocher de krifshë, nom de ce même arbre, élargi en -et.

**kërthnezem, kërthndezem** «rougir; se rajeunir, se raviver, prendre courage, devenir exubérant», i kërthneztë «vif, fort, vigoureux». Un composé à kër- de ndezem «s'allumer, brûler, s'enflammer». La forme mbërdhezem «rougir» représente un composé mbër-dhezem, où dhezem = ndezem.

**kërveshem** «rire moqueur, ricaner». Un composé de vesh «oreille», pour ainsi dire «déformer les lèvres jusqu'aux oreilles». Variantes phonétiques: gërveshem, ngërdheshem, etc.

**kësén** (më) «se dit des douleurs de diverses parties du corps, notamment de l'estomac». Ni emprunté au turc kismak «resserrer», ni apparenté au lit. kencù «supporter, souffrir», gr. πένθος πάθος, etc. Mot dialectal, identique à këcén «sauter», dit des crampes causées par de telles douleurs.

**kështjell** m., kështjellë f. «château», pour des raisons d'ordre phonétique est à ramener plutôt au lat. castellum qu'à l'it. castello. Aussi la lecture kështjël (avec l palatal) est plus vraisemblable. Il s'agit d'un emprunt à la latinité tardive, tout aussi comme dans l'anc. haut all. kastel, moyen irl. castel caisel, etc.

**këshyre, kshyrë**, f. «défilé». La phonétique du mot milite en faveur plutôt d'un emprunt direct au lat. clausūra clūsūra qu'à travers le gr. (moyen ou moderne) κλεισούρα, ou le serbo-cr. ou bulg. klisura. Une couché plus récente est représentée par klisyрэ klysyрэ, qui remonte à une de ces sources.

**këtú** «ici», comme l'a entrevu F. Bopp, est à analyser en kë-tu, kë- représentant l'élément déictique bien connu. -tu est le même élément formatif qu'on trouve dans tuk «où» (tu-k «là où»), tëhu «par ici, de ce côté(-ci)», duke tuke tue «particule qui, avec le participe, forme le gérondif», tutje «là-bas, plus loin, outre, au-delà», ashtu et kështu «ainsi». -tu est le proche parent du sl. tut tu rus. tut «ici», serbo-cr. tu «là, ici», etc.

**kiç** m. «partie postérieure (ou antérieure) d'un navire». Du turc **kiç** «partie postérieure, partie antérieure d'un navire».

**kij** «émonder les vignes», **kizë kizë** f. «espèce de serpe double pour émonder les arbres». Ni emprunté au lat. *incidere* (G. Meyer), ni apparenté à shqyëj shklyej «déchirer, lacérer». La gutturale vélaire devant l'i ne pouvant être, comme telle, de date ancienne, indique la présence d'une voyelle postérieure dans cette même position. Dès lors, une base à -inj, \*këinj, provenant d'un plus ancien \*kadhiniō, rapproche ce mot à kadhë kadhëm «sorte de faucille ou serpe à longue manche, qui sert à couper les ronces et les buissons». **kinj** \*kadh-iniō comme **hyj hij** «entrer» d'un \*hodiniō.

**kinse** «comme si, soi-disant». C'est un des mots issus de phrases, formations «délocutives» très nombreuses dans la langue albanaise: d'un **kini** se «supposez (proprement «avez») que», devenu **kinëse** et **kinse**.

**kite** f. «petite gerbe de blé, poignée d'épis». En tant que mot du dialecte tosque, du bulg. **kitka** «touffe, bouquet de fleurs». A ce même mot appartient aussi **kitë** «crinière du cheval».

**kllapí** f. «délire». Emprunt régional au serbo-cr. **klapa** même sens, élargi en albanais à l'aide du suffixe -i des féminins.

**kodër** f. colline». L'opinion (de H. Schuchardt, P. Skok et J. Brüch) que ce mot remonte, avec le roum. **codru** «forêt, montagne» à un lat. vulgaire (balkanique) **codra codrum** pour **quadra quadrum**, est confirmée par le fait que dans l'ancienne littérature albanaise (Gj. Buzuku, P. Budi) ce mot se présente avec le sens de «pierre angulaire». En grec (ancien et moyen) également qua- initial du latin apparaît souvent comme ko-, **κοδραντης κοτρίγα**. A confronter aussi le nom **Codrato** dans la *Moesia inferior* (H. Mihaescu).

**kokë** f. «tête», aussi «grain de blé, un fruit unique, un oeuf», provient du lat. **coccus** ou **cocum** (G. Weigand, P. Kretschmer), non du gr. **κῶνα** «patera» néo-gr. **κωνί**; pourtant, une origine de l'anc. gr. **κόκκος** n'est pas exclue. Au paire **kokë** f. et **kok** m. de l'albanais correspond exactement le roumain avec **coca** f. et **coc** m. De **kokë** dérivent **kokërr** **kokër** «grain, fruit», **kokël** «sucre en morceau cubique, bonbon» et le pluriel singularisé **koqe** «grain de blé ou de raisin, un fruit, un oeuf (koqe ve); pustule». Le diminutif **kokëë** a passé en roumain comme **coacaza**. Ainsi donc, **kokë** **kok** **kokël** **kokërr** et **koqe** ont une origine commune.

**kokërr**, **kokër** f. «grain de blé ou de fruit». Diminutif de **kokë** au sens de «grain de blé, un fruit unique, un oeuf». De **kokërr** dérive à son tour **kokërrizë** «granule», d'où le verbe **kokërrizoj** «granuler», en outre **kakërruk** «fruit à noyau; noir dure», forme à ouverture de l' en a en syllabe protonique.

**kolásh** m. «polenta». Du bulg. **kulasa** «sorte de bouillie».

**kom** m. **komë** f. «crinière du cheval», est du groupe de **komëtë** «tissage de crin» i **komtë** «de crin de cheval», mots pour lesquels N. Jokl a prouvé la provenance du lat. **coma** «chevelure». A ce même groupe appartient aussi **komezt** pl. «vers qui se forment dans les intestins des brebis». Le roum. **coama** «crinière» atteste l'existence du mot en latin balkanique.

**koqe** f. «grain de blé ou de raisin, un fruit, un oeuf (koqe ve);

*pustule*». La dérivation d'un lat. \*cocceum (de coccum), qui n'existe nulle part, est à écarter. C'est le pluriel singularisé de *kokë* «tête; grain de blé, un fruit unique, un oeuf», *kok m.* «grain».

*korán m.* «nom de poisson, *Salmo letnica*». Emprunté au bulgare.

*koríth, korríth m.* «espèce de raisin». Du nom de la ville de Corinthe, en albanais de Grèce *Korith*; en grec moderne aussi *κορίθι* «raisin de Corinthe».

*korqe f.* «écorce», albanais de Calabre. Non du lat. *corticem*, mais de l'it. dialectal *corchia* «écorce, coquille, pelure», attesté par M. G. Rohlfs.

*korsëm* «comme si». C'est un des mots fréquents issus dans la phrase, de *kor se* = *kur se*, ceci de *sikur se* «comme si, faisant semblant de.»

*kortë f.* «le quart d'une bête (de boucherie) abattue». Identique à *kortë* «mesure de capacité contenant 40 okas» et à *kortarë mpl.* «membres séparés du corps», tous des mots dérivant du lat. *quartus*. Il reste à établir, pourtant, pourquoi dans *kortë* et *kodër lat.* *quæ* est réfléchi par *ko-*, dans *kartë* et *kaçile* par *ka-*.

*korube, karube f.* «ruche». Par identique à *kolibe* «chaumière», mais au contraire le reflet du bulg. *koruba* «arbre creux, cavité d'un arbre» (*Seliscev*). Le mot slave, plutôt que de *kora* «écorce, peau» (*S. Mladenov, M. Vasmer*), provient du gr. *κουρούπιον* «vase brisé, pot à fleurs» *κουρούπα κουρούπι* «pot à fleurs, vase», passé tout aussi en albanais (*korupë, gurupi*). La dénomination des ruches d'après un vase ou le creux d'un arbre est assez fréquente.

*koshëz f.* «oestre», *koshas mpl.* Du lat. *cossus* «ver du bois, espèce d'artisan, et ver intestinal» (*Bogrea, Candrea*).

*kothóm m.* «fondement d'une maison; biens, fortune.» Non pas du gr. *κόθημα* (*A. Xhuvani*), mais du néo-gr. *κούρωμα* qui dénote aussi une cavité dans le mur, auprès de la porte ou de la fenêtre. Ainsi donc ce mot résulte être le même que *kufomë* «cadavre».

*kraharór krahnúr m.* «poitrine; sein». A propos de ce mot il faut retourner à l'étymologie de *D. Çairda* et de *G. Meyer: krah* «le dessus de l'épaule, le haut du bras; aile d'oiseau», au pluriel «dos», et rejeter chaque rapprochement avec le mot suivant.

*krehër krëhër krahën m.* «peigne». Vis-à-vis du verbe (*kreh*, en guègue *kref*), le substantif conserve partout l'h final, et dans son vocalisme l'-a- originaire, l'-e- de *kreh* étant de caractère métaphonique. Au point de vue morphologique il représente un élargissement à suffixe -ën -ër (*G. Meyer*). Le déplacement de l'accent a emmené à *gërhanë* «carde pour peigner la laine».

*krejt* «tout à fait». C'est le génitif-datif de *krye* «tête, chef», employé comme adverbe. Dans *kejet* il y a perte de l'r à l'intérieur du mot, aussi bien comme dans *kezë* et dans *përkiet* «en haut» = *për kriet*.

*krepull* «ivre, soûl», documenté depuis *P. Budi (1621)*. Appartient aux emprunts d'origine romane, pour lesquels on ne peut décider s'il sont d'origine latine ou italienne; cfr. d'une part le lat. *crapula* «état d'ivresse, fumées du vin», d'autre part l'it. *crepare* «crever».

**kreshnik** m. nom des héros légendaires des rhapsodies de l'Albanie septentrionale, appelées par cela kangë kreshnikësh. Ni de kreshhtë «crinière», ni du slave krst «croix», mais du serbo-croate kraisnik «héros», à l'origine «confinaire» (A. Schmauss).

**krezm** m. «onction, sacre», krezmoj «oindre», krezmim m. néologisme. Une dérivation du serbo-cr. krizma est à écarter pour maintes raisons. krezm probablement de l'it. cresima, mais le verbe krezmoj représente une formation interne de l'albanais. La forme krizmë de Gj. Buzuku semble être un emprunt antérieur, ou au lat. chrisma ou au gr. χρῖσμα de l'époque byzantine.

**krifshë**, grifshë, kripç, etc. «Phillyrea media». Nom d'arbre, à formes très variées. Identique au fond à grifshë krifshë «Garrulus glandarius, geai» et à grizhël «pie»: l'arbre doit son nom au feuillage épais, l'oiseau à sa petite huppe. L'origine de ce groupe de mots (auquel se rattachent en outre kripç kripth «espèce d'asperge sauvage», kripth «Loranthus europæus; Viscum album; gangrène», krypësht «Alyssum», etc.), est à chercher plutôt dans krip «cheveu» que dans krife «crinière».

**krua krue** m. «source, fontaine». Pour ce mot d'étymologie si contestée, le rapprochement avec le gr. κρήνη κράνα κράννα «source» κρουνός «jet d'eau» est à retenir en tout cas; seulement la nature du rapport historique existant entre les deux mots est peu claire. Si le sens premier en est «sourdre, couler», on pourrait songer à l'alb. kryej, krej «tirer, extraire», au gr. (Aristote) ὄθεν ὁ Ἀχειῶν ἐκρέων, ou bien à l'alb. krye «tête, chef» ou au gr. κρανίον «crâne».

**krunde** fpl. «son de la farine». En abandonnant tous les rapprochements proposés jusque-là, nous rattachons ce mot au groupe du gr. κρίνω «séparer, trier, distinguer» κριτός «trié, choisi», lat. cerno crevi «trier, passer au crible» cribrum «cribre», vieux irl. criathar «crible», all. Reiter «tamis», etc. La base en est à peu près \*krn-tā ou \*krnā; -un- d'une nasale syllabique.

**krusmë** f. «torture». Du néo-gr κροῦσμα «assaut; attaque».

**kryenéc** «têtu, obstiné». Mot composé, krye- «tête, chef», -nejç «noeux, raboteux», adjectif en -ç(sh) de neje, le pluriel de nye «noeud».

**krypësht** m. «Alyssum». Appartient au groupe de krifshë grifshë kripç «Phillyrea media» grifshë krifshë «geai», etc., toutes formations de krip «cheveu».

**kthill kthjell** «rendre serein», kthillët kthjellët «clair, serein». Des deux formes du mot, celle à -f- (kfill, en Sicile fjeçë, fjeçonem), est à considérer comme la primaire et à rattacher à fill «fil». Ce nom a développé en effet des significations qui se rapprochent de celle de notre mot.

**kuar kuer** m. «modération; ordre; temps libre, occasion», me kuar «moderately» (M. Leake), të përkuerm «abstinentia» i papërkuerm «intemperans» (F. Blanchus). Ni du lat. parcere «retenir, contenir», ni du gr. ancien κόρος «satiété», mais le proche parent de korr kor «moissonner» en tant que «tailler, couper». Cfr. pour le sens le frç. couper le vin et pour kuar kuer «temps» l'all. Zeitabschnitt, le lat. tempus: gr. τέμνω «couper», peut-être aussi le gr. καιρός «mo-

ment opportun, lieu propice, opportunité, temps»: κείρω «tondre, rogner, raser: couper, moissonner».

**kubël** f. «alose». Non pas du slave кѹлб- (rus. kolba, ucr. kolbel, etc., Miklosich, G. Meyer), mais du lat. culpea: forme à métathèse \*culpea ou \*cuplea, d'où dérivent aussi l'esp. kobla, galic. jouba, et le serbo-cr. kobla, ce dernier mot par l'intermédiaire du dalmate.

**kulte** f. «calebasse». Emprunt latin resté inaperçu jusqu'à présent: ou d'un \*cuculbita pour cucurbita, ou d'un \*kurte provenant de cucurbita. Le mot latin survit aussi en roumain.

**kullana** fpl. «dernier jour de l'année, veille du nouvel an; étrennes; première neige». Pas un emprunt au slave koleda (du lat. calendae), auquel remonte à son tour kolendra-t, mais directement du lat. calandae (pour calendae), d'où proviennent en outre le néo-gr. καλάνδαι. le roum. carindar, l'engad. chalanda, l'irl. kalaind, etc.

**kumahárk**, kumihárk m. «libellule». Mot composé kuma-har-k, kumi-har-k, où har = harje harije «Phlebotomus papatasi, espèce de petit cousin, moucheron»; kuma- kumi- est un double préfixe kē-mē-, -k le suffixe bien connu. La morphologie du mot dénote donc un insecte qui ressemble au moucheron.

**kumbull** f. «prune». De l'ancien gr. κοκκύμηλον même sens, et plus précisément d'un dor. kokkúmalon. Le néo-gr. κοῦμλα provient à son tour de l'albanais.

**kumt** m. «nouvelle, message», kumtar «messenger», kumtoj «faire savoir, informer». Emprunt latin resté inaperçu jusque-là: computus «compte», cfr. it. conto frç. compte esp. cuento, etc.; le verbe kumtoj est une dérivation interne de kumt, non pas le reflet du lat. computare. A ce même verbe latin ne remonte non plus kuptoj «comprendre», s'apercevoir, reconnaître, sentir» (voir ce mot). Au lat. computus se réfère, à notre avis, le roum. a se cumpata «se contenir» cumpat «tranquillité d'âme, contenance» qu'on a voulu expliquer du lat. compitum «carrefour»; qu'on confronte pour le sens l'all. berechnend. Dans l'alb. kumt et le roum. cumpat l'o latin est reflété par u, comme dans maints cas.

**kumtër**, kumptër, kundër m. «parrain, compère», est considéré généralement comme le reflet du lat. compater. Il se peut qu'il s'agisse de la continuation de commater «marraine» qu'on suppose être à la base du roum. cumatru et du slave кѹmotra ἀνάδοχος. L'ancienne littérature albanaise conserve encore kumëtrë, comme une forme plus origininaire.

**kund** «en quelque lieu, quelque part; nulle part; à peu près; éventuellement». Ni du lat. unde, ni apparenté à kë «qui» (accus.) et kënd «quelqu'un» (accus.). L'emploi local étant le premier, kund résulte être un élargissement, purement phonétique, de ku «où», comme kënd de kë, send «chose, objet» de se «quoi», cfr. gjëkund «quelque part», en albanais de Grèce gjëkú; gjithkund «partout», en Dalmatie gikú. En effet, chez Buzuku ce mot apparaît encore dans les formes kun et kön, en Grèce gjakún, tout aussi sans -d. Pour l'acceptation de kund «à peu près; éventuellement» cfr. l'all. etwa «à peu près; peut-être; d'aventure, par hasard» qui est apparenté à wo «où».

**kungë** f. «abside, τό ἱερὸν βῆμα», dans Gj. Buzuku konkë,

«*pinnaculum, velum templi*». Du lat. *concha* «coquille; conque», aussi «concaité, voûte du palais». Des combinaisons d'étymologie populaire avec *kungoj kungohem* «communier» *kungim* «communion» d'un côté et *gungë* «bosse» de l'autre, sont probables.

**kuptoj** «comprendre, s'apercevoir, reconnaître, sentir», est une formation interne, un élargissement en -(ë)toj de *kap* «saisir», pas un emprunt au lat. *computare* «compter, mettre en comte» (voir *kumt*). Le développement phonétique a passé par l'échelle *kapttoj: këpttoj: kupttoj*, *këpttoj* se trouve en effet dans les dialectes. Pour le passage sémantique il y a des nombreux parallèles.

**kurnác** «avare». Du turc *kurnaz* «rusé», où s'est introduit pour tant le suffixe péjoratif -ac de l'albanais.

**kurt** m. «cour de maison». Emprunt direct au lat. vulgaire *cōrtem* (pour *cohortem*), tout aussi comme le roum. *curte*, le néo-gr. *κούρτα*, l'it. *corte*, etc. Encore très fréquent dans l'ancienne littérature, ce mot sous l'action de *oborr* et *avlli avli* s'est réduit à un usage régional. *Buzuku* (et *Budi*) conservent encore le genre féminin original, *kurt kurtaja*.

**kurtinë** f. «rideau». Du lat. *cortina* plutôt que de l'it. *cortina*. Le mot latin manque au roumain, mais se trouve en grec moderne.

**kurrë** «jamais». C'est au fond le même mot que *kur* «quand, lorsque». Sa différenciation c'est accomplie dans la phrase. Elle est comparable à celle du frç. *jamais*, qui du sens primitif «en un temps quelconque» a évolué, dans les propositions de négation, à celui de «en aucun temps». En albanais *kurrë* s'est éloigné de *kur* par le renforcement du *r* (gémiation expressive), et du point de vue morphologique à travers des divers préfixes et suffixes, *askurrë*, (si) *moskurrë*, *kurraj*, *kurraj*, *kurajtë*, etc.

**kush** «qui, celui qui». Non emprunté au lat. *quis* (G. Meyer), mais un mot des sources indigènes (H. Pedersen). Le même vaut pour les formes des cas obliques, telles que *kuj kujt* et *kë*. On doit noter cependant que *kush* avec le maintien de son -s présuppose une base bisyllabique, — tout aussi comme *kur* «quand, lorsque» et *mos-ne pas, non»* — ou bien une juxtaposition postérieure. Dans le premier cas un peut songer au pronom (interrogatif, indéfini et relatif) *kuse ksa kse tu tokharien B*.

**kusht** m. «voeu; pari; condition»; *kushtoj* «faire un voeu; vouer, consacrer, dédier», *kushtim* m. «voeu». En partant de *kusht*, on peut considérer ce mot un emprunt à l'ancien it. *costo*, cfr. *ad ogni costo*: *me çdo kusht*, a nuessun *costo*: *me asnjë kusht*. De là le verbe *kushtoj* «faire un voeu; consacrer, dédier». Pourtant *kushton* «coûter» peut être le lat. *constare*, qui survit dans les langues romanes dans cette acception, et qui peut s'être mêlée à *kushtoj* «faire un voeu; vouer, consacrer, dédier». — L'actuel *kuston koston* «coûter» et le nom *kosto* f. «prix de revient» sont des italianismes modernes.

**kushtrim** m. «appel aux armes, alarme». Pas d'un \**kushtorim* dérivé de *kusht kushtoj* (G. Weigand), mais un mot issu de la phrase *kush trim?* «qui est des braves?» (M. Lambertz). Un de ces mots

«délocutifs», assez fréquents en albanais, qui doivent leur formation aux conditions syntaxiques, comme druese, mbase, shklata, etc.

**kuvise** fpl. «mots, paroles, entretiens». Plutôt que d'un postverbal de kuvinj, emprunt prétendu du lat. convenio, il s'agit d'une formation interne: kuvende «entretiens, paroles», du lat. conventum, étant conçu, dans le sentiment linguistique, comme ku-vende, en s'associant à vende «lieux, localités, pays, endroits», cet élément base fut remplacé par le synonyme vise, en donnant naissance à kuvise.